



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.128

2 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 80/2012 datë 13.9.2012	Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për projektin e ndërtimit të <i>bypass</i> -it të Fierit	7141
Ligj nr. 81/2012 datë 13.9.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2 në kontratën financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugës Fier–Tepelenë.....	7172
Ligj nr. 82/2012 datë 13.9.2012	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 1.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”..	7180
Dekret nr.7760 datë 29.8.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	7180
Dekret nr. 7762 datë 3.9.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7181
Akt normativ i KM nr. 5, datë 26.9.2012	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”	7181
Vendim i KM nr.589, datë 5.9.2012	Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2012	7190
Udhëzim i MASH nr. 14, datë 20.7.2012	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2012-2013	7191

Udhëzim i MASH nr. 17, datë 31.7.2012	Për procedurën e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë me kohë të plotë të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë privat, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2012-2013.....	7195
Udhëzim i MASH nr. 19, datë 6.9.2012	Për strukturën e vitit akademik 2012-2013 në institucionet publike të arsimit të lartë.....	7196
Urdhër i MASH nr.326, datë 7.8.2012	Për akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi”, të shkollës së lartë universitare jopublike “Aldent”.....	7197
Urdhër i MASH nr. 327, datë 7.8.2012	Për akreditimin e programeve të studimit “Master i shkencave” në “Menaxhim bankar”; “Administrim biznesi”; “Psikologji klinike” dhe programit të studimit “Master profesional” në “Psikologji klinike” të universitetit “Albanian University”.....	7198
Urdhër i MASH nr. 328, datë 7.8.2012	Për akreditimin institucional dhe programeve të studimit “Bachelor” të shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.....	7198
Urdhër i MASH nr. 329, datë 7.8.2012	Për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në shkenca politike me profil “Administrim publik”; në shkenca juridike me profile: “E drejtë biznesi”, “E drejtë publike” dhe në administrim biznesi me profile: “Shërbime bankare dhe financiare”, “Marketing dhe menaxhim operacionesh”, “Financë kontabilitet”, “Lidership dhe menaxhim burimesh njerëzore” të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti”.....	7199

LIGJ
Nr. 80/2012

**PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE (BEI) PËR PROJEKTIN E
NDËRTIMIT TË *BYPASS* -IT TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për projektin e ndërtimit të *bypass*-it të Fierit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7768, datë 1.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

FI N⁰ 31.045 (AL)
Serapis N⁰ 2007-0204

***BYPASS*-I FIER**
KONTRATË FINANCIARE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
TIRANË, 11 QERSHOR 2012

Kjo kontratë lidhet ndërmjet: Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe të përfaqësuar nga Ministri i Financave z. Ridvan Bode (Huamarrësi), për palën e parë dhe Bankës Europiane të Investimeve me seli në 100 Bul. Konrad Adenauer, Luxembourg, L-2950 Luxembourg përfaqësuar nga zëvendëspresidenti z. Dario Scannapieco (Banka) për palën e dytë.

Duke pasur parasysh se:

1. Huamarrësi ka deklaruar se autoriteti shqiptar i rrugëve, i krijuar në vijim të shndërrimit sipas ligjit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në ndërmarrje publike (Autoriteti Shqiptar i Rrugëve ose "ARRSH") dhe duke qenë se ARRSH-ja është tërësisht operacionale si agjenci zbatimi, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve nëpërmjet ekipit të zbatimit të projektit, secili nën varësinë e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (zbatues), ka ndërmarrë një projekt ndërtimi rreth 22 kilometra të rrugës anësore të autostradës me dy kalime përreth qytetit Fier, siç përshkruhet hollësisht në përshkrimin teknik (përshkrimi teknik) të paraqitur në skedulin A (projekti).



2. Kostoja totale e projektit sipas vlerësimit të Bankës është 81,200,000 euro (tetëdhjetë e një milionë e dyqind mijë euro) dhe Huamarrësi ka deklaruar se synon të financojë projektin si më poshtë:

Burimi	Shuma (mln euro)
Kredi nga Banka	35;
Hua nga BERZH-i	35;
Grant nga Kooperacioni Italian	1.8;
Fondet e veta	9.4;
TOTALI	81.2.

3. Për të përmbushur planin financiar të paraqitur në paragrafin hyrës 2, Huamarrësi ka kërkuar nga Banka një kredi prej 35,000,000 eurosh (tridhjetë e pesë milionë euro). Nënkuptohe se kreditimi nga Banka do të përdoret vetëm për financimin e komponentëve të projektit të lidhura me punimet civile të përshkruara në përshkrimin teknik, që gjithashtu do të bashkëfinancohet nga huaja e BERZH-it.

4. Me vendimin nr. 1080/2011/BE, Parlamenti Europian dhe Këshilli i Bashkimit Europian kanë vendosur të japin një garanci për Bankën, kundër humbjeve të pësura nga huat apo garancitë e huave të dhëna nga viti 2007 deri në 2013, në përputhje me rregullat e veta dhe procedurat për projektet e ndërmarra në disa vende jashtë Bashkimit Europian, të renditura në vendimin e lartpërmendur, duke përfshirë Republikën e Shqipërisë.

5. Marrëveshja kuadër që rregullon aktivitetet e Bankës në territorin e Shqipërisë, e nënshkruar më 5 shkurt 1998 nga Huamarrësi dhe Banka (marrëveshja kuadër) aplikohet për këtë kontratë.

6. Banka, duke marrë parasysh se financimi i projektit përfshihet në objektin e funksioneve të saj dhe duke marrë parasysh deklaratimet dhe faktet e cituara në këta paragrafë hyrës, ka vendosur të realizojë kërkesën e Huamarrësit duke i dhënë një kredi në shumën prej 35,000,000 eurosh (tridhjetë e pesë milionë euro) sipas kësaj kontrate financimi (kontrata), me kusht që shuma e huas së Bankës në asnjë rast nuk do të kalojë 50% (pesëdhjetë për qind) të koston totale të projektit sipas paragrafit hyrës 2.

7. Huamarrësi autorizohet sipas rregullave për të nënshkruar kontratën me anë të dokumentacionit që gjendet në aneksin I të kësaj kontrate. Huamarrësi i konfirmon Bankës statutin e preferuar të kreditorit si institucion financiar ndërkombëtar.

8. Huamarrësi konfirmon se Zbatuesi është tërësisht funksional dhe operativ, dhe i ka të gjitha të drejtat dhe lejet e nevojshme për të realizuar dhe zbatuar projektin.

9. Statuti i Bankës parashikon se Banka do të sigurojë që fondet e saj të përdoren në mënyrë sa më të arsyeshme të jetë e mundur në interesin e Bashkimit Europian dhe, si rrjedhojë, termat dhe kushtet e operacioneve të Bankës për huan duhet të jenë në përputhje me politikat përkatëse të BE-së.

Në përputhje me rekomandimet e task-forcës për veprim financiar, të themeluar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, Banka i kushton vëmendje të veçantë transaksioneve dhe marrëdhënieve të saj të biznesit në ato raste kur jep financim: a) për një projekt me vendndodhje në një vend që nuk zbaton mjaftueshëm ato rekomandime; ose b) për një huamarrës apo përfitues rezident në atë vend.

10. Financimi i projektit përfshin disa subvencione ose grante dhe dhënia e këtyre fondeve është autorizuar dhe do të jepet në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme.

11. BEI çmon se akses në informacion luan rol thelbësor në zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë shkeljen e të drejtave të njeriut në lidhje me projektin që financon. Si rezultat, BEI ka përcaktuar politikën e tij të transparencës, qëllimi i së cilës është të rrisë përgjegjësinë e grupit BEI ndaj grupeve të interesit dhe qytetarëve të BE-së në përgjithësi, duke i dhënë akses në informacionin që do t'u mundësojë atyre të kuptojnë qeverisjen, strategjitë, politikat, aktivitetet dhe praktikatat e tij.

Rrjedhimisht, tashmë është rënë dakord si më poshtë:

Interpretimi dhe përkufizimet

a) Interpretimi

i) Në këtë kontratë referencat për nenet, paragrafët hyrës, skedulet dhe anekset, përveç se kur përcaktohen qartë ndryshe, janë referenca përkatësisht për nenet, paragrafët hyrës, skedulet dhe anekset në këtë kontratë.

ii) Në këtë kontratë referencat ndaj një dispozite të ligjit janë referenca për atë dispozitë të ndryshuar apo të rimiratur.

iii) Në këtë kontratë referencat për çdo lloj marrëveshjeje apo instrument tjetër janë referencë për atë marrëveshje apo instrument tjetër të ndryshuar, përditësuar, shtuar, zgjeruar apo rivendosur.

b) Përkufizimet

Në këtë kontratë:

“Afat i pranimit” për një njoftim është:

a) ora 16:00 e Luksemburgut në datën e dorëzimit, nëse njoftimi është dërguar deri në orën 14:00, ora e Luksemburgut në një ditë pune; ose

b) ora 11:00 sipas orës së Luksemburgut në ditën e ardhshme që është një ditë pune, nëse njoftimi është dërguar pas orës 14:00 sipas orës së Luksemburgut në çdo ditë të tillë, ose nëse është dërguar në një ditë që nuk është ditë pune.

“Autoriteti Rrugor Shqiptar” ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës 1 dhe është krijuar sipas ligjit shqiptar nr. 10 164 të datës 15 tetor 2009.

“Ditë pune” është një ditë (që nuk është e shtunë ose e diel) në të cilën Banka dhe banka të tjera tregtare janë të hapura për punë në Luksemburg.

“Ngjarja e ndryshimit të ligjit” ka kuptimin e dhënë në nenin 4.03A (3).

“Kontratë” ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës 6.

“Kredi” ka kuptimin e dhënë në nenin 1.01.

“Kompensimi i shtyrjes së afatit” është një kompensim i llogaritur mbi shumën e disbursimit të shtyrë apo të pezulluar me një normë përqindjeje (nëse është më e lartë se zero) nga e cila:

- Norma e interesit do të kishte qenë e zbatueshme për një vlerë të tillë, nëse është disbursuar për Huamarrësin në datën e planifikuar për disbursimin

tejkalon

- Norma përkatëse ndërbankare (norma njëmuje) më pak sesa 0.125% (12.5 pikë bazë).

Ky kompensim do t’i shtohet nga data e planifikuar për disbursim, datës aktuale të disbursimit ose sipas rastit deri në datën e anulimit të transhit, në përputhje me këtë kontratë.

“Njoftim për disbursim” është një njoftim nga Banka për Huamarrësin sipas dhe në përputhje me nenin 1.02C.

“Kërkesë për disbursim” është një njoftim kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin C.

“Ngjarje e deformimit” është njëri ose të dy nga:

a) një deformim material ndaj atyre pagesave apo sistemeve komunikimi apo tregje financiare, të cilave në çdo rast u kërkohet të operojnë në mënyrë që pagesat të bëhen në lidhje me këtë kontratë; ose

b) zhvillimi i çdo lloj ngjarjeje tjetër që rezulton në deformim (të natyrës teknike apo të lidhur me sistemin) për veprimet e thesarit apo pagesat si të Bankës, ashtu edhe të Huamarrësit, që e parandalon palën:

i) të përmbushë detyrimet e pagesave sipas kësaj kontrate; apo

ii) të komunikojë me palë të tjera;

dhe deformimi që (si në rastin (a) apo (b) të sipërpërmendur) nuk shkaktohet dhe është jashtë kontrollit të palës së cilës i ndërpriten operacionet.

“Mjedis” nënkupton sa vijon, në masën që ndikon në shëndetin njerëzor dhe mirëqenien sociale:

a) fauna dhe flora;

b) toka, uji, ajri, klima dhe peizazhi, si dhe

c) trashëgimia kulturore dhe mjedisi i ndërtuar,

dhe përfshin pa kufizim çështjet profesionale dhe të shëndetit, sigurisë së komunitetit dhe kushteve të punës.

“Miratim mjedisor” është çdo leje, licencë, autorizim, miratim apo çdo konfirmim tjetër që kërkohet nga ligji mjedisor.



“Pretendim mjedisor” është çdo pretendim, procedurë, njoftim zyrtar apo hetim nga çdo person në përputhje me çdo ligj për mjedisin.

“Ligj për mjedisin” është:

- a) ligji i BE-së, standardet dhe parimet, përveç ndonjë përjashtimi të pranuar nga Banka në funksion të kësaj kontrate, bazuar në ndonjë marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së;
 - b) ligjet kombëtare dhe rregulloret në Republikën e Shqipërisë; dhe
 - c) marrëveshjet e zbatueshme ndërkombëtare,
- nga të cilat një objektiv parësor është ruajtja, mbrojtja apo përmirësimi i mjedisit.

“Plan i veprimit mjedisor dhe social” është plani i parashtruar nga Zbatuesi te Banka më 21 korrik 2011 në lidhje me planifikimin e projektit lehtësimin/përmirësimin, monitorimin, masat këshilluese dhe të formimit institucional të parashikuara për të parandaluar, minimizuar, lehtësuar apo kompensuar ndikimin jo të favorshëm mjedisor dhe social dhe për të rritur ndikimin e dobishëm të projektit, duke specifikuar se si, kur dhe nga kush do të zbatohen këto masa të ndryshueshme herë pas here me miratimin e Bankës.

“EUR” ose “euro” ka kuptimin e monedhës së ligjshme në shtetet anëtare të Bashkimit Europian, të cilat herë pas here e përdorin si monedhë të tyre në përputhje me dispozitat përkatëse të traktatit mbi Bashkimin Europian ose të traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Europian apo traktateve të tyre pasardhëse.

“EURIBOR” ka kuptimin sipas skedulit B.

“Instrument i borxhit të jashtëm” ka kuptimin e dhënë në nenin 7.01.

“Datë përfundimtare e vlefshmërisë” është 15 qershor 2017.

“Normë fikse” është një normë vjetore interesi e përcaktuar nga Banka në përputhje me parimet e aplikuara herë pas here, të përcaktuara nga organet rregullatore të Bankës për huat e dhëna me një normë fikse interesi, të përcaktuara në monedhën e transhit dhe që kanë termat e barasvlershëm për shlyerjen e kapitalit dhe pagimin e interesit.

“Transh me normë fikse” është një transh mbi të cilin aplikohet një normë fikse.

“Normë e ndryshueshme” është një normë interesi e ndryshueshme me shpërndarje fikse, që do të thotë një normë vjetore interesi e përcaktuar nga Banka për çdo periudhë reference pasuese të normës së ndryshueshme të barasvlershme me normën përkatëse ndërbankare, plus/minus *Spread*-in.

“Periudhë reference e normës së ndryshueshme” është çdo periudhë nga njëra datë pagese në datën tjetër përkatëse të pagesës; periudha e parë e referencës së normës së ndryshueshme do të fillojë në datën e disbursimit të transhit.

“Transhi me normë të ndryshueshme” është një transh mbi të cilin aplikohet një normë e ndryshueshme.

“Formulari A/B” është çdo formular, kryesisht në formën e dokumentacionit bashkëlidhur në skedulin E.

“Ngjarja e parapagimit të kompensimit” është ngjarje e parapagimit sipas nenit 4.03A ndryshe nga paragrafi 4.03A(2) ose 4.03A(4).

“Hua” është sasia e përgjithshme e transhit të disbursuar herë pas here nga Banka sipas kësaj kontrate.

“Ngjarja e deformimit të tregut” është në lidhje me një transh specifik të njoftuar:

- a) sipas gjykimit të Bankës, ka rrethana të veçanta që ndikojnë në mënyrë të pafavorshme në aksesin e Bankës në burimet e saj të financimit;
 - b) sipas Bankës, fondet nuk janë të disponueshme nga burimet e saj të zakonshme të financimit për financimin e këtij transhi në monedhën përkatëse dhe/apo për maturimin përkatës dhe/ose në lidhje me profilin e riimbursimit të këtij transhi;
 - c) në lidhje me transhin për të cilin interesi paguhet me një normë të ndryshueshme:
- A) Kostoja e marrjes së fondeve për Bankën nga burimet e saj të financimit, siç përcaktohet nga Banka për një periudhë të barabartë me periudhën referuese të normës së ndryshueshme të një transhi (p.sh. në tregun e parasë) do të ishte më shumë sesa norma përkatëse ndërbankare; ose

B) Banka përcakton se nuk ekzistojnë mjetet e përshtatshme dhe të paanshme për përcaktimin e normës përkatëse ndërbankare të zbatueshme për monedhën përkatëse të këtij transhi ose nuk është e mundur që norma përkatëse ndërbankare të përcaktohet në përputhje me përkufizimin në skedulin B.

“Ndryshim material i pafavorshëm” është, në lidhje me Huamarrësin, çdo ngjarje apo ndryshim kushti që ndikon te Huamarrësi, i cili sipas opinionit të Bankës:

a) ndikon negativisht në aftësinë e Huamarrësit për të kryer detyrimet sipas kontratës; ose

b) ndikon negativisht në kushtet financiare apo perspektivat e Huamarrësit.

“Datë maturimi” është data e fundit apo e vetme e shlyerjes së një transhi të specifikuar sipas nenit 4.01A (b) (iv) ose nenit 4.01B.

“Transh i njoftuar” është një transh në lidhje me të cilin Banka ka nxjerrë një njoftim për disbursim.

“Datë pagimi” janë datat vjetore gjashtëmujore apo tremujore të specifikuara në njoftimin e disbursimit deri në datën e maturimit, përveç kur, në rast se kjo datë nuk është një ditë përkatëse pune, kjo do të thotë:

a) për një transh me normë fikse, dita pasuese përkatëse e punës pa rregullim të interesit për t’u paguar sipas nenit 3.01, me përjashtim të atyre rasteve kur shlyerja bëhet në një kësht të vetëm sipas nenit 4.01B, kur data pararendëse përkatëse e punës do të aplikohet për këtë kësht të vetëm dhe pagesën e interesit të fundit dhe vetëm në këtë rast, me rregullim të interesit sipas nenit 3.01; dhe

b) për një normë të ndryshueshme të transhit, ditën pasuese, nëse ka, të atij muaji kalendarik që është ditë pune ose, nëse nuk ka, dita pararendëse më e afërt që është ditë përkatëse pune, në të gjitha rastet, me rregullimin përkatës të interesit për t’u paguar sipas nenit 3.01.

“Shuma e parapagimit” është shuma e një transhi për t’u parapaguar nga Huamarrësi në përputhje me nenin 4.02A.

“Data e parapagimit” është data që do të jetë datë pagimi në të cilën Huamarrësi propozon të kryejë parapagimin e një shume parapagimi.

“Kompensimi i parapagimit” është në lidhje me çdo shumë principali për t’u parapaguar ose anuluar, shumën e komunikuar nga BEI te Huamarrësi si vlera aktuale (në datën e parapagimit) e tejkaluar, nëse ka, për:

a) interesin që do të akumulohet më pas mbi shumën e parapagimit gjatë periudhës nga data e parapagimit deri në datën e maturimit, nëse nuk është parapaguar; mbi

b) interesin që do të akumulohet gjatë asaj periudhe, nëse do të llogaritej në normën e rivendosjes, më pak se 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë).

Vlera aktuale e lartpërmendur do të llogaritet me një normë zbritjeje të barabartë me normën e rivendosjes, aplikuar në çdo datë përkatëse pagese.

“Njoftimi i parapagimit” është një njoftim me shkrim nga Huamarrësi që specifikon, ndër të tjera, shumën e parapagimit dhe datën e parapagimit, në përputhje me nenin 4.02A.

“Projekt” ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës 1.

“Ekip i zbatimit të projektit” ka kuptimin e dhënë në nenin 1.04B (a) (iii).

“Shpenzim kualifikues” është shpenzimi (duke përfshirë kostot e projektimit dhe të mbikëqyrjes, sipas rastit, dhe taksat neto dhe detyrimet e pagueshme nga Huamarrësi dhe/ose Zbatuesi) i shkaktuar nga Huamarrësi dhe/ose Zbatuesi për projektin, në lidhje me punimet, mallrat dhe shërbimet në zërat e specifikuar në përshkrimin teknik si të përshtatshme për financimin me kredi, objekt i kontratës ose kontratave të zbatuara në kushte të pranueshme për Bankën, duke marrë parasysh botimin më të fundit të udhëzuesit të prokurimeve të Bankës, të publikuar në faqen e saj të internetit. Me qëllim llogaritjen e ekuivalentit në euro të çdo shume të shpenzuar në një monedhë tjetër, Banka do të aplikojë normën referuese të këmbimit të llogaritur dhe të publikuar për atë monedhë nga Banka Europiane Qendrore në atë datë që bie brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve para datës së disbursimit që Banka do të vendosë (ose në pamundësi të asaj norme, norma apo normat përkatëse të këmbimit që mbizotëronin në atë kohë në çdo lloj tregu financiar të zgjedhur nga Banka).



“Norma e rivendosjes” është norma fikse në fuqi ditën e llogaritjes së kompensimit për huat me normë fikse interesi të emëtuara në të njëjtën monedhë dhe të cilat do të kenë të njëjtat kushte për pagesën e interesit dhe të njëjtin profil shlyerjeje për ditën e maturimit të transhit në lidhje me të cilin propozohet apo kërkohet të bëhet një parapagim. Për ato raste kur periudha është më e shkurtër sesa 48 muaj (ose 36 muaj në mungesë të një shlyerjeje të principalit gjatë asaj periudhe), do të përdoret norma ekuivalente më e afërt korresponduese e tregut, kjo është norma përkatëse ndërbankare minus 0.125% (12.5 pikë bazë) për periudha deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Për periudha që bien midis 12 dhe 36/48 muaj, sipas rastit, do të aplikohet pika e ofertës në normat e këmbimit, publikuar nga *Intercapital* në *Reuters* për monedhën në fjalë dhe respektuar nga Banka në kohën e llogaritjes.

“Ditë pune përkatëse” është ditë pune sipas ditëve kalendarike të punës.

“Normë përkatëse ndërbankare” do të thotë EURIBOR.

“Plani i veprimit rivendosës” do të thotë plani i muajit korrik 2011 i përfunduar nga Zbatuesi dhe që i dorëzon Bankës detajim të veprimeve për t’u kryer për rivendosje dhe kompensim të personave që janë zhvendosur apo do të zhvendosen fizikisht apo ekonomikisht si rezultat i zbatimit të projektit, i cili mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Bankës.

“Direktiva e menaxhimit të sigurisë së infrastrukturës rrugore” do të thotë direktiva 2008/96 EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian, e ndryshuar dhe e shtuar herë pas here.

“Datë e përcaktuar disbursimi” do të thotë data kur është planifikuar disbursimi i transhit në përputhje me nenin 1/02C.

“Sigurim” do të thotë çdo hipotekim, garanci, pengim si garanci pagese, detyrim, hipotekim ose çdo formë tjetër sigurimi interesi që siguron çdo detyrim të dikujt ose çdo marrëveshje apo masë tjetër me efekt të ngjashëm.

“Spread” është diferenca fikse të norma përkatëse ndërbankare (qoftë plus apo minus) përcaktuar nga Banka dhe njoftuar Huamarrësit në njoftimin përkatës të disbursimit.

“Përshkrim teknik” ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës 1.

“Transh” do të thotë çdo pagesë e kryer apo për t’u kryer sipas kësaj kontrate.

Neni 1

Kredia dhe disbursimet

1.01 Shuma e kredisë

Me anë të kësaj kontrate, Banka akordon në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon kredinë në shumën 35,000,000 euro (tridhjetë e pesë milionë euro) për financimin e projektit (kredia).

1.02 Procedura e disbursimit

1.02A Transhet

Banka do të disbursojë kredinë deri në 10 (dhjetë) transhe. Vlera e secilit transh, nëse nuk është balanca e patërhequr e kredisë, do të jetë një vlerë minimale prej 3,000,000 euro (tre milionë euro).

1.02B Kërkesa e disbursimit

a) Huamarrësi mund t’i paraqesë Bankës një kërkesë për disbursim për disbursimin e një transhi që do të merret jo më vonë ose së paku 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës përfundimtare të vlefshmërisë. Kërkesa për disbursim do të ketë formën e përcaktuar në skedulin C dhe do të specifikojë:

i) shumën dhe monedhën e transhit;

ii) datën e preferuar të disbursimit të transhit; kjo datë duhet të jetë një ditë pune përkatëse që bie të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas datës së kërkesës së disbursimit dhe në ose para datës përfundimtare të vlefshmërisë, ku është e kuptueshme që Banka mund ta disbursojë transhin deri në 4 (katër) muaj kalendarikë nga data e kërkesës për disbursim;

iii) nëse transhi është një transh me normë fikse apo transh me normë të ndryshueshme, secili sipas dispozitave përkatëse të nenit 3.01;

iv) periodicitetin e preferuar të pagesës së interesit për transhin, zgjedhur në përputhje me nenin 3.01;

v) kushtet e preferuara për shlyerjen e principalit të transhit, zgjedhur në përputhje me nenin 4.01;

vi) datat e para dhe të fundit të preferuara të shlyerjes së principalit për transhin;
vii) kodin IBAN (apo formatin e duhur në përputhje me praktikën bankare lokale) dhe SWIFT BIC të llogarisë bankare, ku duhet të kryhet disbursimi i transhit në përputhje me nenin 1.02 D.

b) Nëse Banka, në vijim të një kërkesë nga Huamarrësi, para paraqitjes së kërkesës për disbursim, ka siguruar Huamarrësin me një normë jodetyruese interesi fiks ose përqindje mbi normën fikse për t'u aplikuar për transhin, Huamarrësi, me zgjedhjen e tij, mund të specifikojë një kuotim të tillë në kërkesën për disbursim, d.m.th.:

i) në rastin e një transhi me normë fikse, norma e lartpërmendur fikse e interesit më parë e cituar nga Banka; ose

ii) në rastin e një transhi në normë të ndryshueshme, përqindja mbi normën fikse e lartpërmendur, e cituar më parë nga Banka, e aplikueshme për transhin deri në datën e maturimit.

c) Çdo kërkesë për disbursim do të shoqërohet me prova të autorizimit të personit apo personave të autorizuar për ta nënshkruar atë dhe modeli i nënshkrimit të këtij personi apo personave; për të shmangur dyshimet, për kërkesat për disbursim në vijim të të parës, të nënshkruar nga i njëjti nënshkrues apo disa nënshkrues si e para, kjo provë mund të përbëjë të njëjtën provë dokumentuese të autoritetit, të plotësuar për kërkesën për disbursimin e parë, me kusht që të mos u nënshtrohet kufizimeve në kohë apo kufizimeve të tjera.

d) Sipas nenit 1.02 C(b), çdo kërkesë për disbursim është e parevokueshme.

1.02C Njoftimi i disbursimit

a) Nëse kërkesa e disbursimit pajtohet me këtë nen 1.02, Banka do t'i dorëzojë Huamarrësit një njoftim disbursimi jo më pak sesa 10 (dhjetë) ditë para datës së propozuar të planifikuar të një transhi, ku do të specifikojë:

i) shumën e transhit;

ii) datën e planifikuar të disbursimit;

iii) normën bazë të interesit për transhin, që do të jetë: i) transh me normë fikse; ose ii) transh me normë të ndryshueshme, të gjitha sipas dispozitave përkatëse të nenit 3.01;

iv) datën e pagimit të interesit të parë dhe periodicitetin e pagimit të interesit për transhin;

v) kushtet për shlyerjen e principalit për transhin;

vi) datat e para dhe të fundit për shlyerjen e principalit për transhin;

vii) datën e pagimit të aplikueshëm për transhin;

viii) për një transh me normë fikse, norma fikse dhe për një transh me normë të ndryshueshme, përqindja mbi normën fikse e aplikuar për transhin deri në datën e maturimit.

b) nëse njëri ose më shumë nga elementet e specifikuara në njoftimin për disbursim, nuk pasqyrojnë elementin përkatës në kërkesën për disbursim, nëse ka, Huamarrësi pas marrjes së njoftimit për disbursimin, mund të tërheqë kërkesën për disbursim me njoftim me shkrim Bankës, i cili do të merret jo më vonë se ora 12:00, ora e Luksemburgut në ditën e nesërme të punës dhe pas kësaj, kërkesa për disbursim dhe njoftimi për disbursim nuk do të jenë të vlefshme. Nëse Huamarrësi nuk ka tërhequr me shkrim kërkesën për disbursim brenda kësaj periudhe kohore, Huamarrësi do të konsiderohet se ka pranuar të gjitha elementet e specifikuara në njoftimin për disbursim.

c) nëse Huamarrësi i ka paraqitur Bankës një kërkesë për disbursim, në të cilën Huamarrësi nuk ka specifikuar normën fikse të interesit apo përqindjen mbi normën fikse, sipas nenit 1.02B(b), Huamarrësi do të konsiderohet se ka pranuar paraprakisht normën fikse apo përqindjen mbi normën fikse, siç është specifikuar në njoftimin për disbursim.

1.02D Llogaria e disbursimit

Disbursimi do të bëhet në llogarinë e Huamarrësit, pasi Huamarrësi të njoftojë me shkrim Bankën, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së planifikuar për disbursimin (me kodin IBAN ose me formatin e duhur sipas praktikave bankare lokale) në kërkesën e disbursimit.

Vetëm një llogari mund të specifikohet për çdo transh.

1.03 Monedha e disbursimit

Banka do të disbursojë çdo transh në euro.

1.04 Kushtet për disbursim



1.04A Transhi i parë

Paraqitja e kërkesës për disbursim për transhin e parë, sipas nenit 1.02 do të konsiderohet efektive pas marrjes nga Banka në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, të dokumenteve apo dëshmime, si më poshtë:

a) dëshmi të pranueshme për Bankën që realizimi i kësaj kontrate nga Huamarrësi është autorizuar sipas rregullave dhe që personi apo personat që nënshkruajnë kontratën në emër të Huamarrësit është/janë të autorizuar të veprojnë kështu së bashku me modelin e nënshkrimit të çdo personi apo personave;

b) një opinion ligjor i nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë për Huamarrësin që konfirmon se:

i) realizimi i kësaj kontrate nga Huamarrësi është i autorizuar dhe që personi apo personat që nënshkruajnë kontratën në emër të Huamarrësit është/janë të autorizuar për të vepruar kështu, bashkë me modelin e nënshkrimit të secilit person apo personave;

ii) lidhja e kësaj kontrate dhe realizimi i saj nga Huamarrësi janë ratifikuar me ligj nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë;

iii) kjo kontratë është tërësisht në fuqi dhe e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kushtet e saj;

iv) Zbatuesi duhet të ketë marrë të gjitha miratimet, autorizimet, licencat apo aprovimet e autoriteteve qeverisëse apo publike të kërkuara në lidhje me këtë kontratë, sipas datës së planifikuar të disbursimit;

v) që asnjë kufizim kontrolli, këmbimi apo leje nuk kërkohet, në mënyrë që të lejohet marrja e të gjitha shumave që do të disbursohen në llogarinë e veçantë të përmendur në nenin 1.02D dhe për të lejuar shlyerjen e huas dhe pagimin e interesit dhe të gjitha shumave të tjera sipas kësaj kontrate.

c) të provojë se zbatuesi ka marrë të gjitha miratimet, autorizimet, licencat apo aprovimet e autoriteteve qeverisëse apo publike të kërkuara në lidhje me zbatimin e projektit;

d) të provojë që një audit i sigurisë rrugore është kryer në lidhje me projektimin e detajuar, në përputhje me parimet e direktivës së menaxhimit të sigurisë infrastrukturore rrugore dhe rekomandimet e këtij audit të jenë përfshirë në planin e projektit ose nëse nuk janë përfshirë, të ketë deklarime shpjeguese që e sqarojnë këtë përjashtim;

e) të provojë se autoriteti kompetent mjedisor ka dhënë vendimin e favorshëm për projektin dhe të jenë marrë të gjitha miratimet mjedisore;

f) të provojë se autoriteti kompetent për ruajtjen e natyrës ka dhënë mendim mbi rëndësinë e ndikimit të projektit në zonat e mbrojtura dhe speciet sipas formularit A/B ose ekuivalent;

g) të provojë se autoriteti kompetent për arkeologjinë, kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore ka dhënë opinionin e tij mbi rëndësinë e ndikimit të projektit për monumentet e mbrojtura;

h) të provojë se një plan veprimi rivendosës, i pranueshëm nga Banka është aprovuar nga autoritetet përkatëse;

i) të provohet nga Zbatuesi se të gjitha blerjet e tokave të nevojshme për zbatimin e projektit dhe procesi i rivendosjes në lidhje me projektin, të jenë plotësuar tërësisht; dhe

j) një plan të detajuar prokurimi nga zbatuesi në lidhje me projektin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

1.04B Të gjitha transhet

a) Paraqitja e kërkesës për disbursim për çdo transh sipas nenit 1.02, duke përfshirë të parën, do të konsiderohet efektive pas marrjes nga Banka, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, të dokumenteve dhe provave si më poshtë:

i) një certifikatë nga Huamarrësi në formën e skedulit D me shkresë drejtuar nga Huamarrësi;

ii) dëshmi nga zbatuesi të pajtueshmërisë me kërkesat e sigurimit sipas nenit 6/05 (c);

iii) dëshmi nga zbatuesi se ekipi përgjegjës për zbatimin e projektit dhe për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar të gjitha aspektet e zbatimit, përfshirë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve për projektin (ekipi i zbatimit të projektit) është në funksionim, është i plotësuar si duhet me staf të kualifikuar, ka burime të mjaftueshme, kompetencë dhe asistencë teknike dhe kushtet e duhura të referencës, sipas pëlqimit të Bankës dhe është përgjegjës për koordinimin e projektit gjatë të gjithë

periudhës së zbatimit të tij;

iv) dëshmi nga zbatuesi për mobilizimin e një inxhinieri të pavarur mbikëqyrës me staf, burime dhe kushte reference të pranueshme për Bankën;

v) dëshmi nga zbatuesi që provon se në vijim të tërheqjes së transhit përkatës, shuma e përgjithshme e huas nuk do të tejkalojë shpenzimin e përgjithshëm të shkaktuar ose të kryer kontraktualisht nga Huamarrësi në lidhje me projektin deri në datën e kërkesës përkatëse për disbursim; dhe

vi) një kopje të çdo lloj autorizimi tjetër apo dokumenti, opinionit apo sigurimi, të cilën Banka, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, ka njoftuar Huamarrësin se është e nevojshme në lidhje me kontratën;

vii) Përveç transhit të parë, dëshmi që mund të pritët se Huamarrësi dhe/ose zbatuesi të kenë shkaktuar, deri në ditën e 120-të, që bie pas datës së preferuar për disbursimin të specifikuar në kërkesën për disbursim, shpenzimet kualifikuese në një sasi të paktën të barabartë me agregatin: i) 100% e shumave të të gjitha transheve të disbursuara, më parë; dhe ii) 80% të shumës së transhit për t'u disbursuar (100% e shumës së transhit, nëse ky transh është transhi i fundit për t'u disbursuar);

b) Disbursimi i çdo transhi sipas nenit 1.02 është kushtëzues për faktin që në datën e planifikuar të disbursimit për transhin e propozuar:

i) përfaqësimet dhe garancitë që janë përsëritur sipas nenit 6.07 janë të përshtatshme në të gjitha aspektet; dhe

ii) asnjë rast apo rrethanë që përbën ose do të përbëjë me kalimin e kohës apo dhënien e njoftimit sipas kontratës:

aa) një rast mosplotësimi të detyrimeve sipas nenit 10.01; ose

bb) një rast parapagimi sipas nenit 4.03, të ketë ndodhur dhe vazhdon i pakompensuar ose nuk është hequr dorë nga to ose do të rezultojë nga transhi i propozuar.

1.05 Shtyrja e afatit të disbursimit

1.05A Arsyet për shtyrjen

Me kërkesën me shkrim nga Huamarrësi, Banka do të shtyjë afatin e disbursimit të çdo transhi të njoftuar në tërësi ose pjesërisht në një datë të specifikuar nga Huamarrësi që është një datë që bie jo më pak sesa 6 (gjashtë) muaj nga data e planifikuar e disbursimit dhe jo me vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së parapagimit të parë të transhit të përfshirë në njoftimin e disbursimit. Në këtë rast, Huamarrësi do të paguajë kompensimin për shtyrjen e afatit të llogaritur mbi vlerën e disbursimit të shtyrë.

Çdo kërkesë për shtyrje afati do të jetë në fuqi për një transh, vetëm nëse bëhet të paktën 7 (shtatë) ditë pune para datës së planifikuar të disbursimit.

Nëse për një transh të njoftuar, ndonjë nga kushtet e përmendura në nenin 1.04 nuk përmbushet si në datën e specifikuar dhe në datën e planifikuar të disbursimit, disbursimi do të shtyhet në një datë të rënë dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, që bie jo më parë se 7 (shtatë) ditë pune pas plotësimit të të gjitha kushteve të disbursimit (pa cenuar të drejtën e Bankës për të pezulluar dhe/ose anuluar pjesën e papaguar të kredisë në tërësi apo pjesërisht, sipas nenit 1.06 B. Në këtë rast, Huamarrësi do të paguajë kompensimin për shtyrjen e afatit të llogaritur në vlerën e disbursimit të shtyrë.

1.05B Anulimi i një disbursimi të shtyrë me 6 (gjashtë) muaj

Me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, Banka mund të anulojë një disbursim që është shtyrë sipas nenit 1.05A për më shumë se 6 (gjashtë) muaj në total. Vlera e anuluar do të mbetet e vlefshme për disbursim sipas nenit 1.02.

1.06 Anulimi apo pezullimi

1.06A E drejta e Huamarrësit për anulim

Me njoftim me shkrim drejtuar Bankës, Huamarrësi mund të anulojë në çdo kohë, tërësisht apo pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm, pjesën e padisbursuar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk do të ketë efekt në lidhje me një transh të njoftuar që ka një datë disbursimi të planifikuar që bie brenda 7 (shtatë) ditësh pune nga data e njoftimit.



1.06B E drejta e Bankës për pezullim apo anulim

Banka mund të pezullojë apo anulojë pjesën e padisbursuar të kredisë, tërësisht apo pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm, duke njoftuar me shkrim Huamarrësin për:

i) ndodhinë e një rasti apo rrethane të përmendur në nenin 4.03A ose 10.01 apo një rast apo rrethanë që do të përbënte me kalimin e kohës dhe me njoftim sipas kësaj kontrate, një rast sipas nenit 4.03 A ose një rast mosplotësimi detyrimesh sipas nenit 10.01; ose

ii) nëse ndodh një ndryshim i pafavorshëm material.

Çdo pezullim do të vazhdojë derisa Banka të përfundojë pezullimin apo të anulojë shumën e pezulluar.

1.06 C Kompensimi për pezullimin apo anulimin e një transhi

1.06 C(1) Pezullimi

Nëse Banka pezullon një transh të njoftuar, qoftë mbi një rast parapagimi të kompensueshëm apo një rast të përmendur në nenin 10.01 ose me ndodhjen e një ndryshimi të pafavorshëm material, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës kompensimin e shtyrjes së llogaritur në vlerën e disbursimit të pezulluar.

1.06C(2) Anulimi

Nëse sipas nenit 1.06A, Huamarrësi anulon:

a) një transh me normë fikse që është një transh i njoftuar, do të kompensojë Bankën sipas nenit 4.02B;

b) një transh të njoftuar me normë të ndryshueshme ose çdo pjesë të kredisë të ndryshme nga një transh i njoftuar, asnjë kompensim nuk është i pagueshëm.

Nëse Banka anulon:

i) një transh me normë fikse që është një transh i njoftuar mbi rastin e parapagimit të kompensimit ose mbi ndryshimin e pafavorshëm material ose sipas nenit 1.05B, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës kompensimin e parapagimit; ose nëse Banka anulon;

ii) një transh të njoftuar mbi një rast të përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi do të kompensojë Bankën sipas nenit 10.03.

Përveçse në këto raste, asnjë kompensim nuk do të paguhet mbi anulimin e një transhi nga Banka.

Kompensimi do të llogaritet mbi bazat që vlera e anuluar çmohet të jetë disbursuar dhe shlyer në datën e planifikuar të disbursimit ose në masën që disbursimi i transhit është aktualisht i shtyrë apo i pezulluar, në datën e njoftimit të anulimit.

1.07 Anulimi pas mbarimit të afatit të kredisë

Në çdo kohë pas datës përfundimtare të vlefshmërisë, Banka mund të njoftojë Huamarrësin dhe pa detyrim nga ana e palës tjetër, të anulojë një vlerë të tillë të kredisë në lidhje me të cilën asnjë kërkesë disbursimi nuk është bërë në përputhje me nenin 1.02B.

1.08 Shumat e kërkueshme sipas nenit 1

Shumat e kërkueshme sipas neneve 1.05 dhe 1.06 do të paguhet në euro. Ato do të paguhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja nga Huamarrësi, e kërkesës nga Banka ose brenda një periudhe më të gjatë të specifikuar në kërkesën e Bankës.

Neni 2

Huaja

2.01 Shuma e huas

Huaja do të përfshijë vlerën e përgjithshme të transheve të disbursuara nga Banka sipas kredisë, pas konfirmimit nga Banka sipas nenit 2.03.

2.02 Monedha e shlyerjes, interesi dhe detyrime të tjera

Interesi, shlyerjet dhe detyrime të tjera të pagueshme në lidhje me çdo transh do të kryhen nga Huamarrësi në monedhën në të cilën është disbursuar transhi.

Çdo pagesë tjetër do të bëhet në monedhën e caktuar nga Banka, duke marrë në konsideratë monedhën e shpenzimeve për t'u rimbursuar me anë të asaj pagese.

2.03 Konfirmimi nga Banka

Brenda 10 (dhjetë) ditësh pas disbursimit të çdo transhi, Banka do të dorëzojë te Huamarrësi tabelën e amortizimit të përmendur në nenin 4.01, nëse është e përshtatshme, që përcakton datën e disbursimit, monedhën, vlerën e disbursuar, kushtet e shlyerjes dhe normën e interesit të dhe për atë transh.

Neni 3

Interesi

3.01 Norma e interesit

Normat fikse dhe normat e ndryshueshme janë të vlefshme për periudha prej jo më pak se 4 (katër) vjet ose, në mungesë të shlyerjes së principalit gjatë asaj periudhe, jo më pak se 3 (tre) vjet.

3.01A Transhet me normë fikse

Huamarrësi do të paguajë interes mbi balancën e papaguar të çdo transhi me normë fikse në një normë fikse me bazë tremujore, gjashtëmujore apo vjetore në vonesë të datave përkatëse të pagimit, siç specifikohet në njoftimin e disbursimit, duke filluar në datën e parë të kësaj pagese pas datës së derdhjes së transhit. Nëse koha nga data e kryerjes së disbursimit të bërë për datën e parë të disbursimit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë ose më pak sesa pagesa e interesit e akumuluar gjatë kësaj periudhe do të shtyhet për datën vijuese të pagimit.

Interesi do të llogaritet mbi bazat e nenit 5.01 (a) me një normë vjetore që është normë fikse.

3.01B Transhet me normë të ndryshueshme

Huamarrësi do të paguajë interes mbi balancën e vonuar të çdo transhi me normë të ndryshueshme me bazë tremujore, gjashtëmujore apo vjetore në vonesë të datave përkatëse të pagimit, siç specifikohet në njoftimin e disbursimit, duke filluar në datën e parë të kësaj pagese mbi të cilën është kryer derdhja për transhin. Nëse koha nga data e derdhjes së pagesës së parë është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë ose më pak sesa pagesa e interesit e akumuluar gjatë kësaj periudhe, do të shtyhet për datën vijuese të pagimit.

Banka do t'i njoftojë Huamarrësit normën e ndryshueshme brenda 10 (dhjetë) ditësh pas fillimit të secilës periudhë reference të normës së ndryshueshme.

Nëse sipas neneve 1.05 dhe 1.06, disbursimi i çdo transhi me normë të ndryshueshme ndodh pas datës së planifikuar të disbursimit, norma përkatëse ndërbankare e zbatueshme për periudhën e parë të referencës të normës së ndryshueshme do të aplikohet sikur derdhja të jetë bërë në datën e planifikuar për disbursim.

Interesi do të llogaritet në lidhje me çdo periudhë reference të normës së ndryshueshme mbi bazën e nenit 5.01 (b).

3.02 Interesi në shumat që u ka kaluar afati

Pa cenuar nenin 10 dhe me anë të përjashtimit të nenit 3.01, interesi do të akumulohet mbi një shumë që i ka kaluar afati, të pagueshme sipas kushteve të kësaj kontrate nga data e pagimit në një normë vjetore të barabartë me normën përkatëse ndërbankare plus 2% (200 pikë bazë) dhe do të jetë e pagueshme në përputhje me kërkesën e Bankës. Me qëllim përcaktimin e normës përkatëse ndërbankare në lidhje me nenin 3.02, periudhat përkatëse brenda kuptimit të skedulit B do të jenë periudhat pasuese prej një muaji, duke filluar në datën e pagimit.

Megjithatë, interesi mbi një shumë që i ka kaluar afati nën një transh me normë fikse, do të paguhet me normën vjetore që është shuma e normës së përcaktuar në nenin 3.01A plus 0.25% (25 pikë bazë), nëse tejkalohet ajo normë vjetore, për çdo periudhë kohore përkatëse, norma e specifikuar në paragrafin pararendës.

Nëse shuma e vonuar është në monedhë të ndryshme nga monedha e huas, do të zbatohet norma e mëposhtme për vit, domethënë norma përkatëse ndërbankare që zakonisht mbahet nga Banka për transaksionet në atë monedhë plus 2% (200 pikë bazë), e llogaritur në përputhje me praktikën e tregut



për këtë normë.

3.03 Rasti i mosfunksionimit të tregut

Nëse në çdo kohë midis datës së nxjerrjes nga Banka të një njoftimi disbursimi në lidhje me transhin dhe datës që bie dy ditë pune para datës së planifikuar të disbursimit, ndodh një rast mosfunksionimi i tregut, banka mund të njoftojë Huamarrësin që kjo klauzolë ka hyrë në fuqi.

Në rastin e një transhi të njoftuar për t'u disbursuar në euro, norma e interesit të aplikuar për këtë transh deri në datën e maturimit do të jetë norma (e shprehur si një normë me përqindje vjetore) që përcaktohet nga Banka për të qenë kosto gjithëpërfshirëse për Bankën për financimin e transhit përkatës, bazuar mbi normën referuese të nxjerrë në nivel të brendshëm, të Bankës në atë kohë ose një metodë përcaktuese norme alternative të përcaktuar nga Banka. Huamarrësi do të ketë të drejtën të refuzojë me shkrim këtë disbursim brenda afatit të përcaktuar në njoftim dhe si rrjedhojë do të mbartë detyrimet, nëse ka, ndërsa Banka nuk do të kryejë disbursime dhe kredia korresponduese do të mbetet e vlefshme për disbursim sipas nenit 1.02B. Nëse Huamarrësi nuk e refuzon në kohë disbursimin, palët bien dakord që disbursimi dhe kushtet si pasojë do të jenë detyruese për të dyja palët.

Në këtë rast, përqindja mbi normën fikse apo norma fikse e njoftuar më parë nga Banka në njoftimin e disbursimit nuk do të jetë më e zbatueshme.

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja normale

4.01A Shlyerja me këste

a) Huamarrësi do të shlyejë çdo trash me këste në datat e pagimit të specifikuara në njoftimin përkatës të disbursimit, në përputhje me kushtet e tabelës së amortizimit sipas nenit 2.03.

b) çdo tabelë amortizimi do të ndërtohet mbi bazat që:

i) në rastin e një transhi me normë fikse, shlyerja do të bëhet me bazë vjetore, gjashtëmujore dhe tremujore, me këste të barabarta të principalit apo këste konstante të principalit dhe interesit;

ii) në rastin e një transhi me normë të ndryshueshme, shlyerja do të bëhet me këste të barabarta të principalit dhe të interesit me bazë vjetore, gjashtëmujore dhe tremujore;

iii) data e parë e shlyerjes së çdo transhi do të jetë datë pagese që nuk bie më herët sesa 60 ditë nga data e planifikuar e disbursimit dhe jo më vonë sesa data e parë e pagimit që bie menjëherë pas përvjetorit të 5-të (të pestë) të datës së planifikuar të disbursimit të transhit; dhe

iv) shlyerja e fundit e çdo transhi do të jetë një datë pagese që nuk bie më herët sesa 4 (katër) vjet dhe jo më vonë sesa 20 (njëzet) vjet pas datës së planifikuar të disbursimit.

4.01B Kësti i vetëm

Në mënyrë alternative, Huamarrësi mund të shlyejë transhin në një pagesë të vetme në një datë pagese të specifikuar në njoftimin e disbursimit, që është një datë që nuk bie më pak sesa 3 (tre) vjet ose më shumë sesa 12 (dymbëdhjetë) vjet nga data e planifikuar e disbursimit.

4.02 Parapagimi vullnetar

4.02A Opsioni i parapagimit

Sipas neneve 4.02B, 4.02C dhe 4.04, Huamarrësi mund të shlyejë të gjithë apo një pjesë të çdo transhi, bashkë me interesin e akumuluar dhe sigurimin, nëse ka, mbi një njoftim parapagimi të paktën me njoftim 1 muaj para, që specifikon vlerën e parapagimit dhe datën e parapagimit.

Sipas nenit 4.02C, njoftimi i parapagimit do të jetë detyrues dhe i parevokueshëm.

4.02B Sigurimi i parapagimit

4.02B(1) Transhi me normë fikse

Nëse Huamarrësi parapaguan një transh me normë fikse, ai do t'i paguajë Bankës në datën e parapagimit kompensimin e parapagimit.

4.02B(2) Transhi me normë të ndryshueshme

Huamarrësi mund të parapaguajë transhin me normë të ndryshueshme pa kompensim në çdo datë përkatëse të pagimit.

4.02C Mekanizmat e parapagimit

Banka do të njoftojë Huamarrësin jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së parapagimit të vlerës së parapagimit, për interesin e akumuluar të kërkueshëm për të dhe të kompensimit të pagueshëm sipas nenit 4.02B ose, sipas rastit, nëse nuk ka kompensim.

Jo më vonë se përfundimi i afatit të pranimit, Huamarrësi do të njoftojë Bankën:

- a) për të konfirmuar njoftimin e parapagimit mbi bazat e kushteve të specifikuar nga Banka; ose
- b) që tërheq njoftimin e parapagimit.

Nëse Huamarrësi jep konfirmimin sipas paragrafit (a) më sipër, do ta kryejë pagesën. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin për parapagimin ose nuk e konfirmon atë në kohën e caktuar, nuk mund ta kryejë parapagimin. Përveçse sa më sipër, njoftimi i parapagimit do të jetë i detyrueshëm dhe i pabërthor.

Huamarrësi do të shoqërojë parapagimin me pagimin e interesit të akumuluar dhe kompensimit, nëse ka, për vlerën e parapagimit.

4.03 Parapagimi i detyrueshëm

4.03A Shkaqet për parapagimin

4.03A(1) Reduktimi i kostos së projektit

Nëse kostoja totale e projektit do të reduktohet nga shifra e deklaruar në paragrafin hyrës 2 në një nivel në të cilën vlera e kredisë kalon 50% (pesëdhjetë për qind) të kësaj kostoje, Banka në raport me uljen mund të anulojë pjesën e paderdhur të kredisë dhe ose të kërkojë parapagimin e huas duke njoftuar Huamarrësin. Huamarrësi do të kryejë pagesën e vlerës së kërkuar në datën e caktuar nga Banka, kjo datë nuk duhet të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

4.03A(2) *Pari passu* për financim jo nga BEI

Nëse Huamarrësi vullnetarisht parapaguan (për të shmangur çdo dyshim, parapagimi do të përfshijë riblerjen ose anulimin, kur është e zbatueshme) një pjesë ose të gjithë financimin tjetër jo nga BEI dhe ky parapagim nuk bëhet nga të ardhurat e një huaje, që ka një afat të paktën të barabartë me afatin që nuk ka kaluar të financimit të parapaguar jo nga BEI, Banka duke njoftuar Huamarrësin mund të anulojë pjesën e padisbursuar të kredisë dhe të kërkojë parapagimin e huas. Pjesa e huas që Banka mund të kërkojë të parapaguhet do të jetë e njëjtë me atë të vlerës së parapaguar që ka financimi jo nga BEI për vlerën e mbetur agregate nga të gjitha financimet jo nga BEI.

Huamarrësi do të kryejë pagesën e vlerës së kërkuar në datën e caktuar nga Banka, kjo datë nuk duhet të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllimet e këtij neni, “Financimi jo nga BEI” përfshin çdo hua (përveç huas dhe çdo huaje tjetër direkte nga Banka), obligacion kredie apo formë tjetër borxhi financiar apo detyrimi për pagesën apo ripagesën e parasë fillimisht të dhënë të Huamarrësi për një afat prej më shumë se 3 (tre) vjet.

4.03A(3) Ndryshimi i ligjit

Huamarrësi duhet të informojë menjëherë Bankën, nëse ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodhë një ngjarje ndryshimi ligji. Në këtë rast, ose nëse Banka ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se një ngjarje ndryshimi ligji ka ndodhur apo do të ndodhë, Banka mund t’i kërkojë Huamarrësit konsultim. Ky konsultim do të ndodhë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e kërkesës së Bankës. Nëse pas mbarimit të 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kësaj kërkesë për konsultim, Banka ka mendimin se ndikimet e ngjarjes së ndryshimit të ligjit nuk mund të lehtësohen në favorin e saj, Banka duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë pjesën e padisbursuar të kredisë dhe të kërkojë parapagimin e huas, bashkë me interesin e akumuluar dhe të gjitha shumat e akumuluar të mbetura sipas kontratës.

Huamarrësi do të kryejë pagesën e vlerës së kërkuar në datën e caktuar nga Banka; kjo datë nuk duhet të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllime të këtij neni, “ngjarje e ndryshimit të ligjit” do të thotë dekretim, shpallje, përmbushje apo ratifikim, ose çdo ndryshim apo modifikim për çdo ligj, rregull apo rregullore (ose në aplikimin ose interpretimin e çdo ligji, rregulli apo rregulloreje), duke përfshirë çdo ligj, rregull apo rregullore në lidhje me Zbatuesin që ndodh pas datës së kësaj kontrate dhe, e cila, sipas mendimit të Bankës, do të dëmtojë materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet sipas kësaj kontrate apo çdo sigurim sipas kësaj kontrate.



4.03A(4) Paligjshmëria

Nëse bëhet e paligjshme në çdo juridiksion të zbatueshëm për Bankën, të kryejë ndonjë nga detyrimet e saj sipas kësaj kontrate apo të financojë dhe të vazhdojë huan, Banka menjëherë do të njoftojë Huamarrësin dhe: i) mund të pezullojë apo anulojë pjesën e padisbursuar të kredisë; dhe/ose ii) mund të kërkojë parapagimin e huas në datën e caktuar nga Banka në njoftimin për Huamarrësin.

4.03A(5) Shpenzimi kualifikues më pak sesa vlera e transhit

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi:

a) brenda 120 ditëve pas disbursimit të çdo transhi, do të shkaktojë shpenzime kualifikuese në një vlerë që të jetë të paktën e barabartë me agregatin prej 80% të vlerës së atij transhi dhe 100% të vlerave të të gjitha transheve të disbursuara më parë, nëse ka.

b) brenda 120 ditëve pas disbursimit të transhit të fundit, do të shkaktojë shpenzime kualifikuese në një vlerë që të jetë të paktën e barabartë me agregatin prej 100% të vlerës së atij transhi dhe 100% të vlerave të të gjitha transheve të disbursuara më parë, nëse ka.

Si dëshmi e pajtueshmërisë me detyrimet e mësipërme, Huamarrësi do të japë ose sigurojë që Zbatuesi të japë në mënyrë të pranueshme për Bankën, dokumente në gjuhën angleze ose të shoqëruara me një përkthim në anglisht.

Nëse në lidhje me çdo transh të disbursuar, Huamarrësi nuk dorëzon apo siguron që Zbatuesi t'i dorëzojë Bankës çdo dokument sipas nenit 4.03A(5) në data përkatëse të caktuara, Banka mund të kërkojë parapagimin e pjesës së transhit që tejkalon vlerën e shpenzimit kualifikues shkaktuar nga Huamarrësi, i në lidhje me të cilën Huamarrësi ka dhënë dëshmi të pranueshme për Bankën.

4.03B Mekanizmat e parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka sipas nenit 4.03, së bashku me interesin apo vlera të tjera të grumbulluara apo të mbetura sipas kësaj kontrate, duke përfshirë pa kufizim çdo kompensim sipas nenit 4.03C, do të paguhet në datën e caktuar nga Banka në njoftimin e kërkesës.

4.03C Kompensimi i parapagimit

Në rastin e ngjarjes së kompensimit të parapagimit, parapagimi, nëse ka, do të përcaktohet në përputhje me nenin 4.02B.

Nëse, për më tepër, sipas ndonjë dispozite të nenit 4.03A Huamarrësi parapaguan një transh në një datë tjetër nga data përkatëse e pagesës, Huamarrësi do të kompensojë Bankën në atë vlerë që Banka do të vërtetojë se kërkohet për ta kompensuar atë për të marrë fondet sesa në një datë pagese përkatëse.

4.04 Të përgjithshme

Një vlerë e parapaguar nuk mund të rimerret hua. Neni 4 nuk cenon nenin 10.

Neni 5

Pagesat

5.01 Përcaktimi i llogaritjes së ditëve

Çdo vlerë bazuar në interes, kompensim apo tarifë nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate dhe e llogaritur në lidhje me një fraksion të një viti, do të përcaktohet në përcaktimet përkatëse si më poshtë:

a) në lidhje me interesin dhe kompensimet sipas një transhi me normë fikse, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe një muaj me 30 (tridhjetë) ditë;

b) në lidhje me interesin dhe kompensimet sipas një transhi me normë të ndryshueshme, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe numrin e ditëve të kaluara;

c) në lidhje me tarifat, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe numrin e ditëve të kaluara.

5.02 Koha dhe vendi i pagesës

Nëse nuk caktohet ndryshe, të gjitha shumat përveç shumës së interesit, kompensimit apo principalit do të jenë të pagueshme nga Huamarrësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e kërkesës së Bankës.

Çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj kontrate do të paguhet në llogarinë përkatëse të caktuar nga Banka për Huamarrësin. Banka do të përcaktojë llogarinë jo më pak se 15

(pesëmbëdhjetë) ditë para datës së kërkueshme për pagesën e parë nga Huamarrësi dhe do të njoftojë çdo ndryshim të llogarisë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para pagesës së parë mbi të cilën aplikohet ndryshimi. Kjo periudhë njoftimi nuk do të zbatohet në rastin e pagesës sipas nenit 10.

Shuma nga Huamarrësi do të konsiderohet e paguar kur Banka ta marrë atë.

5.03 *Set-off* (e drejta e Bankës për konfiskimin e gjendjes së llogarisë së klientit për ta përdorur për shlyerjen e detyrimeve)

Banka mund të përfitojë kompensim për çdo detyrim të maturuar të kërkueshëm nga Huamarrësi sipas kësaj kontrate (në masën e përfutur nga Banka) kundrejt çdo detyrimi (të maturuar apo jo) që Banka ka borxh ndaj Huamarrësit, pa marrë parasysh vendin e pagesës, degën e arkëtimit apo valutën e çdo detyrimi. Nëse detyrimet janë në monedha të ndryshme, Banka mund të konvertojë çdo detyrim me normë këmbimi të tregut në kursin normal të biznesit për qëllim të kompensimit. Nëse detyrimi është i palikuiduar apo i papërcaktuar, Banka mund të vendosë kompensim në një vlerë të llogaritur nga ajo në mirëbesim që të jetë vlera e detyrimit.

5.04 Deformimi i sistemeve të pagesave

Nëse Banka përcakton se (në diskrecionin e saj) që ka ndodhur një rast deformimi ose Banka njoftohet nga Huamarrësi që ka ndodhur një rast deformimi:

a) Banka mund dhe, nëse kërkohet, do të konsultohet me Huamarrësin, me qëllim rënien dakord mbi ndryshime të tilla ndaj veprimtarisë apo administrimit të kontratës, siç Banka mund ta çmojë të nevojshme në ato rrethana;

b) Banka nuk do të jetë e detyruar të konsultohet me Huamarrësin në lidhje me ndonjë ndryshim të përmendur në paragrafin (a) nëse, sipas mendimit të saj, nuk është e praktikueshme të veprohet kështu në ato rrethana dhe në çdo rast nuk do të ketë detyrim të bjerë dakord për këto ndryshime; dhe

c) Banka nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëm, kosto apo humbje që rrjedh si rezultat i një rasti deformimi ose për marrjen apo mosmarrjen e ndonjë veprimi në lidhje me këtë nen 5.04.

5.05 Aplikimi i shumave të marra

a) Pagesat e pjesshme

Nëse Banka merr një pagesë që nuk është e mjaftueshme për të shlyer të gjitha shumat e maturuara dhe të pagueshme për Huamarrësin sipas kësaj kontrate, Banka do të aplikojë atë pagesë në apo kundrejt pagesës:

i) së pari, në apo kundrejt pagesës proporcionale të tarifave, kostove apo sigurimeve dhe shpenzimeve për t'u paguar sipas kësaj kontrate;

ii) së dyti, në apo kundrejt interesit të akumuluar për t'u paguar sipas kësaj marrëveshjeje;

iii) së treti, në apo kundrejt pagesës së principalit për t'u paguar sipas kësaj kontrate; dhe

iv) së katërti, në apo kundrejt pagesës së ndonjë shume tjetër për t'u paguar sipas kësaj kontrate.

b) Alokimi i shumave në lidhje me transhet

i) Në rastin e:

- një parapagimi të pjesshëm vullnetar të një transhi që është subjekt i shlyerjes në disa këste, vlera e parapagimit do të aplikohet proporcionalisht për çdo këst të mbetur;

- një parapagim të pjesshëm të detyrueshëm të një transhi që është subjekt i shlyerjes në disa këste, vlera e parapagimit do të aplikohet në zbritje të kësteve të mbetura në rend të anasjellë maturimi.

ii) shumat e marra nga Banka në vijim të një kërkesë sipas nenit 10.01 dhe të aplikuara për një transh, do të reduktojnë këstet e vonuara në rend të anasjellë maturimi. Banka mund të aplikojë shumat e marra midis transheve me zgjedhjen e saj;

iii) në marrjen e shumave që nuk mund të identifikohen si të aplikueshme për një transh të caktuar, dhe mbi të cilat nuk ka marrëveshje ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për aplikimin e tyre, Banka mund të aplikojë këto midis transheve, me zgjedhjen e saj.

Neni 6

Angazhimet dhe përfaqësimet e Huamarrësit

Angazhimet në këtë nen 6 mbeten në fuqi nga data e kësaj kontrate për aq kohë sa çdo shumë mbetet e papaguar sipas kësaj kontrate ose kredia është në fuqi.



A. Angazhimet e projektit

6.01 Përdorimi i huas dhe vlefshmëria e fondeve të tjera

Huamarrësi do të përdorë dhe do të sigurojë që Zbatuesi të përdorë të gjitha shumatat e marra nga ai sipas huas për përmbushjen e projektit.

Huamarrësi do të sigurojë që atij dhe Zbatuesit t'i vihen në dispozicion fonde të tjera të renditura në paragrafin hyrës 2 dhe që këto fonde të shpenzohen në masën e kërkuar për financimin e projektit.

6.02 Përmbushja e projektit

Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi ta kryejë projektin në përputhje me përshkrimin teknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës dhe ta përfundojë atë në datën përfundimtare të përcaktuar.

6.03 Kostoja e rritur e projektit

Nëse kostoja totale e projektit tejkalon shifrën e llogaritur në paragrafin hyrës 2, Huamarrësi do të sigurojë financimin për kostot e tepërta pa iu drejtuar Bankës, për të mundësuar që projekti të realizohet në përputhje me përshkrimin teknik. Planet për financim të kostos së tepërt do t'i komunikohen Bankës pa vonesë.

6.04 Procedura e prokurimit

Huamarrësi do të sigurojë që Livruesi do të blejë pajisjet, të sigurojë shërbimet dhe të urdhërojë punimet për projektin, në përputhje me planin e prokurimit që do të aprovohet nga Banka, të ndryshuar herë pas here nga tenderët e hapur ndërkombëtarë ose proceduara të tjera të pranueshme për prokurim, duke përmbushur pritshmëritë e Bankës me politikat e saj, të përshkruara në "Udhëzuesin e saj për prokurimet" në fuqi në datën e kësaj kontrate.

6.05 Vazhdimi i angazhimeve të projektit

Huamarrësi do të kërkojë që Zbatuesi:

a) Mirëmbajtja: të mirëmbajë, riparojë, rindërtojë dhe restaurojë të gjitha pronat që janë pjesë e projektit, siç kërkojnë të ruhen në një gjendje të mirë pune;

b) Asetet e projektit: (përveç kur Banka nuk jep miratimin e saj me shkrim) të mbajë titullin për dhe zotërimin e të gjitha aseteve kryesore që përmban projekti ose, sipas rastit, t'i zëvendësojë dhe rinovojë këto asete dhe të mirëmbajë projektin në veprim të vazhdueshëm, në përputhje me qëllimin kryesor, me kusht që Banka mund të refuzojë miratimin e saj, vetëm kur veprimi i propozuar do të cenojë interesin e Bankës si Huadhënës për Huamarrësin, ose do ta bëjë projektin të papërshtatshëm për financim nga Banka sipas statutit të saj ose sipas nenit 309 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian;

c) Sigurimi: të sigurojë të gjitha punimet dhe pronat pjesë të projektit, në shoqëri sigurimesh të klasit të parë, në përputhje me praktikat përkatëse gjithëpërfshirëse të industrisë;

d) Të drejtat dhe lejet: të ruajë në fuqi të gjitha të drejtat e kalimit apo përdorimit dhe të gjitha lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e nevojshme për kryerjen dhe veprimtarinë e projektit;

e) Probleme mjedisore dhe sociale:

i) të zbatojë dhe të vërë në zbatim projektin në përputhje me ligjin për mjedisin;

ii) të marrë dhe të ruajë miratimet e kërkuara për mjedisin në projekt;

iii) të jetë në përputhje me miratimet mjedisore; dhe

iv) të ndërmarrë zbatimin e të gjithë komponentëve të projektit në përputhje me rekomandimet e lejeve përfundimtare nga autoritetet përkatëse mjedisore.

f) Ligji i BE-së: të ekzekutojë dhe të vërë në zbatim projektin në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe të gjitha standardet përkatëse të ligjit të BE-së, përveçse ndonjë derogimi të përgjithshëm të bërë nga Bashkimi Europian;

g) Plani i veprimit rivendosës: të realizojë blerjen e tokës dhe rivendosjen jovullnetare në përputhje me planin e veprimit rivendosës, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;

h) Plani i veprimit mjedisor dhe social: të zbatojë projektin në përputhje me planin e veprimit mjedisor dhe social;

i) Plani i operacioneve dhe mirëmbajtjes: 6 (gjashtë) muaj përpara vënies në zbatim të projektit, përgatit një plan operativ dhe të mirëmbajtjes për rrugën, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe, më pas, vazhdon ta zbatojë këtë plan deri në maturimin e huas; dhe

j) Aksesit për rrugën: të parandalojë ndërtimin e ndonjë hyrjeje të paautorizuar në rrugën e projektit dhe të kufizojë rreptësisht autorizimin e ndonjë hyrjeje të re në përputhje me funksionin e saj si korridor ndërkombëtar.

6.06 Pajtueshmëria me ligjet

Huamarrësi dhe Zbatuesi do të respektojnë të gjitha ligjet dhe rregullat të cilave u nënshtrohen ata apo projekti.

6.07 Përfaqësimet dhe garancitë e përgjithshme

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton te Banka (që):

a) mund të ekzekutojë, dorëzojë dhe kryejë të gjitha detyrimet sipas kësaj kontrate dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe performancën e ngjashme me të;

b) kjo kontratë përbën detyrimet e tij ligjore të vlefshme detyruese dhe të zbatueshme;

c) ekzekutimin dhe dorëzimin e përmbushjes së detyrimeve të tij sipas pajtueshmërisë me dispozitat e kësaj kontrate dhe:

i) nuk do të shkelë apo nuk do të jetë në kundërshtim me ndonjë ligj të zbatueshëm, statut, rregull apo rregullore ose ndonjë gjykim, dekret apo leje së cilës i nënshtrohet;

ii) nuk do të shkelë apo nuk do të jetë në kundërshtim me ndonjë marrëveshje apo instrument tjetër për të cilin mund të pritët të ketë ndikim material të pafavorshëm në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj kontrate;

iii) nuk do të shkelë apo nuk do të jetë në kundërshtim me ndonjë ligj apo rregullore detyruese për të.

d) që nuk ka pasur ndryshim material të pafavorshëm;

e) asnjë ngjarje apo rrethanë që përbën një rast mosplotësimi detyrimesh sipas nenit 10.01 nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon të jetë e parregulluar dhe nga të cilat nuk është hequr dorë;

f) që asnjë çështje gjyqësore, arbitrazh, procedim administrativ apo hetim nuk është duke ndodhur ose sipas dijenisë së tij, nuk rrezikon të jetë pezull në gjykatë, trup arbitrazhi apo agjenci që ka rezultuar ose është përcaktuar në të kundërt se do të rezultojë në një ndryshim material të pafavorshëm, dhe as nëse vazhdon kundër tij apo ndonjë ndihmësi të gjykimit ndonjë vendim gjyqësor i pakënaqshëm;

g) ka lëshuar dhe/ose ka marrë të gjitha miratimet, autorizimet, licencat apo aprovimet e nevojshme nga autoritetet qeveritare apo publike ose autoritetet në lidhje me këtë kontratë dhe në mënyrë që të përmbushë ligjërisht detyrimet e tij sipas projektit dhe të gjitha miratimet, autorizimet, licencat apo aprovimet që janë në fuqi dhe të pranueshme në mënyrë të dukshme;

h) detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj kontrate klasifikohen jo më pak sesa, *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tanishme dhe të ardhshme të pasiguruara dhe të parenditura sipas ndonjë prej instrumenteve të borxhit, përveç detyrimeve të preferueshme nga ligji, që aplikohen përgjithësisht nga kompanitë;

i) ai dhe/ose Zbatuesi është në përputhje me nenin 6.05 (e) dhe sipas njohurisë dhe besimit të tij (pas një hetimi të saktë dhe të kujdesshëm) asnjë pretendim mjedisor nuk ka filluar apo nuk e rrezikon atë;

j) është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues dhe zotëron asetet në lidhje me projektin në datën e lidhjes së kësaj kontrate, nuk ekziston sigurim mbi asetet e tyre;

k) është në përputhje me të gjitha sipërmarrjet sipas seksionit 6; dhe

l) Zbatuesi dhe ekipi zbatues i projektit janë tërësisht funksionalë dhe operativë me të gjitha të drejtat dhe lejet për të vazhduar projektin.

Përfaqësimet dhe garancitë e përmendura më lart do të jenë të vlefshme për kohëzgjatjen e kësaj kontrate dhe konsiderohen të përsëritura në çdo datë të planifikuar për disbursim dhe në çdo datë pagese.

6.08 Angazhimi i paprekshmërisë



6.08A Huamarrësi garanton dhe ndërmerr që ai dhe Zbatuesi dhe asnjë person tjetër, sipas dijenisë së tij aktuale, nuk kanë kryer ndonjë nga aktet e mëposhtme dhe që ata dhe asnjë person, me pëlqim apo njohuri të mëparshme, nuk do të kryejë akte të tilla si:

a) ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi i ndonjë avantazhi të papërshtatshëm për të ndikuar në veprimin e një personi që mban një post publik ose funksion të një drejtori ose punonjësi të një autoriteti publik, sipërmarrje publike, drejtor, nëpunës i një organizate publike dhe ndërkombëtare në lidhje me procesin e prokurimit ose me ekzekutimin e një kontrate në lidhje me ato elemente të projektit të përshkruara në përshkrimin teknik; ose

b) çdo akt që ndikon në mënyrë të papërshtatshme ose ka si qëllim të ndikojë në këtë mënyrë në procesin e prokurimit apo zbatimin e projektit në dëm të Huamarrësit apo Zbatuesit, duke përfshirë marrëveshjet e fshehta midis tenderuesve.

Për këtë qëllim, njohuria e ministrit të Huamarrësit, sekretarit të shtetit, ndihmësit të ministrit të Huamarrësit, këshilltarit të një ministri të Huamarrësit, menaxherit apo anëtarit të stafit të Zbatuesit do të çmohet njohuri e Huamarrësit. Huamarrësi duhet dhe do të marrë masa që Zbatuesi të informojë Bankën nëse vihet në dijeni të një fakti apo informacioni që tregon kryerjen e një akti të tillë.

6.08B Huamarrësi do të fillojë, do të ruajë dhe do të përmbushë procedura dhe kontrole të brendshme në përputhje me ligjet kombëtare dhe praktikën më të mira të zbatueshme, me qëllim që të garantojë se asnjë transaksion nuk do të bëhet ose në përfitim të ndonjë individi apo institucioni të përmendur në listat e përditësuara të personave të miratuar të shpallur nga Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara apo komitetet e tij sipas rezolutave të Këshillit të Sigurisë 1267 (1999), 1373 (2001) (www.un.org/terrorism) dhe/ose nga Këshilli i BE-së sipas pozicioneve të përbashkëta të tij 2001/931/CSFP dhe 2002/402/CSFP dhe rezolutat e tyre përkatëse ose pasuese dhe/ose për aktet zbatuese në lidhje me financimin e çështjeve të terrorizmit.

6.09 Autoriteti Rrugor Shqiptar

Huamarrësi ndërmerr që Autoriteti Rrugor Shqiptar do të jetë funksional dhe operativ me të gjitha të drejtat dhe lejet për të vazhduar dhe zbatuar projektin deri më 30 qershor 2013.

Neni 7

Siguria

Sipërmarrjet në nenin 7 mbeten në fuqi nga data e lidhjes së kësaj kontrate për atë kohë sa ndonjë shumë mbetet e papaguar sipas kësaj kontrate apo kredia është në fuqi.

7.01 Klasifikimi *pari passu*

Huamarrësi do të sigurojë që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj kontrate klasifikohen dhe do të klasifikohen jo më pak se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e pasiguruar dhe të parenditura tashmë dhe të ardhshme sipas instrumenteve të borxhit të jashtëm.

Në veçanti, nëse Banka bën një kërkesë sipas nenit 10.01 ose ndonjë rast ose rast potencial mosplotësimi detyrimesh sipas instrumentit të borxhit të jashtëm të pasiguruar dhe të nënrenditur të Huamarrësit ose të ndonjë prej agjencive apo instrumenteve ka ndodhur dhe vazhdon, Huamarrësi nuk do të bëjë (ose autorizojë) ndonjë pagesë në lidhje me instrumentin e borxhit të jashtëm (i planifikuar rregullisht ose ndryshe) pa paguar njëkohësisht apo veçuar në një llogari të caktuar për pagesën në datën e ardhshme të pagesës, një shumë të barabartë me të njëjtën pjesë të borxhit të mbetur sipas kësaj kontrate, që pjesa e pagesës sipas instrumentit të borxhit të jashtëm ka ndaj totalit të borxhit të mbetur sipas atij instrumenti. Për këtë qëllim, nuk do të merret parasysh asnjë pagesë e instrumentit të borxhit të jashtëm që është bërë jashtë të ardhurave të emitimit të një instrumenti tjetër për të cilin kanë nënshkruar kryesisht të njëjtët persona me pretendime sipas instrumentit të borxhit të jashtëm.

Në këtë Marrëveshje “Instrument i borxhit të jashtëm” është: a) instrumenti që përfshin një gjendje llogarie që evidenton ose që përbën një detyrim për të shlyer huan, depozitim, paradhënie apo zgjatje të ngjashme kredie (që përfshin pa kufizim zgjatjen e kredisë me një marrëveshje rifinancimi apo riprogramimi); b) një detyrim i evidentuar nga një obligacion, dëftesë borxhi apo evidencë e ngjashme e borxhit; ose c) një garanci e dhënë nga Huamarrësi për një detyrim të palës së tretë, me kusht që në çdo

rast ky detyrim është: i) i rregulluar nga një sistem i ligjit sesa një ligj për Huamarrësin; ose ii) i pagueshëm në monedhën që s'është e vendit të Huamarrësit; ose iii) i pagueshëm te një pronar i inkorporuar, vendas, rezident ose me seli biznesi jashtë vendit të Huamarrësit.

7.02 Garancia shtesë

Nëse Huamarrësi i jep një palë të tretë garanci për realizimin e një instrumenti të borxhit të jashtëm, preference apo prioriteti në lidhje me të, Huamarrësi, nëse do të kërkohet nga Banka, do t'i japë Bankës garanci ekuivalente për kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate apo t'i japë Bankës preferencën apo prioritetin ekuivalent.

7.03 Klauzolat e përfshirjes

Nëse Huamarrësi lidh me një kreditor tjetër afatmesëm apo afatgjatë një marrëveshje financimi që përfshin një dispozitë mbi mospasjen e një tatimi apo detyrimi dhe/ose një dispozitë me dëm të tërthortë dhe/ose një dispozitë *pari passu*, që është më e rreptë sesa një dispozitë(a) ekuivalente e kësaj kontrate, Huamarrësi, me kërkesë të Bankës, do të informojë Bankën dhe do të nënshkruajë një marrëveshje për ndryshimin e kësaj kontrate për të parashikuar një dispozitë ekuivalente në favor të Bankës.

Neni 8

Informacioni dhe vizitat

8.01 Informacioni në lidhje me projektin

Huamarrësi do të ose do të sigurojë që Zbatuesi:

a) do të dorëzojë në Bankë:

i) informacionin në formë dhe përmbajtje dhe në periudhat kohore të specifikuar në programin A.2 apo ndryshe, siç është rënë dakord herë pas here nga palët e kësaj kontrate; dhe

ii) çdo informacion të tillë apo dokument tjetër në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, operimin dhe çështjet mjedisore të/ose për projektin që Banka kërkon në një afat kohor të arsyeshëm.

Në çdo rast që nëse ky informacion apo këto dokumente nuk janë dorëzuar te Banka në kohë, dhe Huamarrësi nuk e korrigjon pjesën e lënë në një kohë të arsyeshme të vendosur nga Banka me shkrim, Banka mund ta rregullojë këtë mungesë, në masën e mundshme, duke punësuar staf të saj in ose një konsulent ose një palë të tretë me shpenzimet e Huamarrësit, dhe Huamarrësi do t'u japë këtyre personave ndihmën e nevojshme për këtë qëllim;

b) të dorëzojë për aprovim në Bankë pa vonesë çdo ndryshim material në projekt, gjithashtu, duke marrë parasysh njoftimet nga Banka në lidhje me projektin përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, ndër të tjera në lidhje me çmimin, planprojektin, planet, orarin apo programin e shpenzimeve, apo planin e financimit për projektin;

c) menjëherë të informojë Bankën për:

i) çdo veprim apo protestë të filluar, apo kundërshtim të ngritur nga një palë e tretë, apo ankim i mirëfilltë i marrë nga Huamarrësi për pretendime mjedisore që sipas dijenisë së tij, ka filluar, është pezull apo e rrezikon atë në lidhje me mjedisin apo çështje të tjera që ndikojnë te projekti; dhe

ii) çdo fakt apo rast në dijeni të Huamarrësit që cenon apo ndikon te kushtet e kryerjes apo veprimtarisë së projektit; dhe

iii) çdo mospërputhje nga ana e tij, me ndonjë ligj për mjedisin; dhe

iv) çdo pezullim, revokim apo ndryshim të miratimeve mjedisore;

dhe të përcaktojë veprimet për t'u ndërmarë në lidhje me këto çështje.

d) t'i japë Bankës, nëse kërkohet:

i) një certifikatë të siguriesve të tij që tregon plotësimin e kërkesave sipas nenit 6.05(c);

ii) një listë të politikave në fuqi, mbi bazë vjetore, që mbulojnë pronën e siguruar, pjesë të projektit, së bashku me konfirmimin e pagesës të primeve aktuale.

8.02 Informacion për Huamarrësin

Huamarrësi:

a) do të informojë Bankën menjëherë për:



- i) çdo fakt që detyron atë të parapaguajë borxhet financiare të financimit nga BE-ja;
- ii) çdo rast apo vendim që përbën apo mund të rezultojë në rastet e përshkruara në nenin 4.03;
- iii) çdo qëllim nga ana e tij për të dhënë garanci mbi asetet e tij në favor të një pale të tretë apo të hyjë në marrëveshje të llojit të përshkruar në nenin 7;
- iv) çdo qëllim nga ana e tij apo e Zbatuesit për të refuzuar pronësinë e komponentëve materialë të projektit;
- v) çdo fakt apo rast që mund të pengojë plotësimin e çdo detyrimi të Huamarrësit sipas kësaj kontrate;
- vi) çdo rast të renditur në nenin 10.01 që ka ndodhur apo që rrezikon të ndodhë ose është parashikuar; dhe
- vii) çështje gjyqësore, arbitrazh apo procedim administrativ, apo hetim që është kryer, rrezikon apo është pezull, që në të kundërt mund të përcaktojë një ndryshim material të pafavorshëm.

8.03 Vizitat nga Banka

Huamarrësi do të lejojë persona të caktuar nga Banka, si dhe persona të caktuar nga institucione të tjera të BE-së, kur kjo të kërkohej nga dispozita përkatëse të detyrueshme të ligjit të BE-së, për të vizituar vendndodhjet, ndërtimet dhe punimet e projektit dhe për të kryer këto kontrole sipas dëshirës dhe t'u ofrojë atyre apo t'u sigurojë që t'u ofrohet e gjithë asistencë e nevojshme për këtë qëllim.

Huamarrësi pranon se Banka mund të jetë e detyruar të publikojë një informacion të tillë në lidhje me Huamarrësin dhe projektin për çdo institucion apo organ të BE-së, në përputhje me dispozitat përkatëse të detyrueshme të ligjit të BE-së.

8.04 Hetimet dhe informacioni

Huamarrësi ndërmerr:

- a) të marrë çdo veprim të tillë që mund të kërkojë Banka për të hetuar dhe/ose dhënë fund çdo veprimi të dyshuar ose të pretenduar të natyrës së përshkruar në nenin 6.08.
- b) të informojë Bankën për masat e marra në lidhje me dëmet nga personat përgjegjës për çdo humbje që vjen nga ky akt; dhe
- c) të lehtësojë çdo hetim që Banka mund të ketë në lidhje me një akt të tillë.

Neni 9

Detyrimet dhe shpenzimet

9.01 Taksat, tatimet dhe tarifat

Huamarrësi duhet të paguajë të gjitha taksat, tatimet, tarifat dhe detyrimet e tjera të çdo natyre, duke përfshirë taksën e pullës dhe tarifat e regjistrimit, që rrjedhin nga ekzekutimi i zbatimit të kësaj kontrate apo çdo dokumenti tjetër në lidhje me krijimin, perfeksionimin, regjistrimin apo zbatimin e çdo garancie për huan në masën e zbatueshme.

Huamarrësi do të paguajë të gjithë principalin, interesin, sigurimet dhe shumat e tjera për t'u paguar sipas kësaj kontrate bruto pa zbritje të asnjë lloji takse lokale apo kombëtare; me kusht që nëse Huamarrësi detyrohet të bëjë një zbritje të tillë, do të plotësojë pagesën Bankës, në mënyrë që pas zbritjes, vlera neto e marrë nga Banka të jetë ekuivalente me shumën e kërkuar.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi do të përballojë të gjitha detyrimet dhe shpenzimet, duke përfshirë shpenzimet profesionale, bankare apo të këmbimit valutor të shkaktuara në lidhje me përgatitjen, ekzekutimin, zbatimin dhe përfundimin e kësaj kontrate apo çdo dokumenti tjetër dhe për ndryshimin, plotësimin, apo heqjen dorë në lidhje me këtë marrëveshje apo çdo dokumenti tjetër dhe për ndryshimin, krijimin, menaxhimin dhe realizimin e çdo garancie për huan.

Banka do të sigurojë mbështetjen me dokumentacion për çdo detyrim apo shpenzim 14 (katërmëdhjetë) ditë para kërkesës së saj për pagesë.

Neni 10
Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

10.01 E drejta për të kërkuar shlyerje

Huamarrësi do të shlyejë menjëherë të gjithë apo pjesë të huas, bashkë me interesin e akumuluar dhe të gjitha shumat e tjera të akumuluar apo të papaguara sipas kësaj kontrate, pas një kërkesë me shkrim të bërë nga Banka në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

10.01A Kërkesa e menjëhershme

Banka mund ta bëjë këtë kërkesë menjëherë nëse:

a) Huamarrësi nuk arrin në datën e duhur të paguajë një pjesë të huas, të paguajë interesin apo të kryejë çdo pagesë për Bankën, siç parashikohet në këtë kontratë;

b) çdo informacion apo dokument i dhënë për Bankën nga apo në emër të Huamarrësit, një përfaqësim apo deklaram i bërë apo që çmohet të bëhet nga Huamarrësi në zbatim të kësaj kontrate apo në lidhje me negociimin apo përmbushjen e kësaj kontrate është apo dëshmon të ketë qenë i pasaktë, i paplotë apo çorientues në lidhje me aspekte materiale;

c) Pas një rasti mosplotësimi detyrimesh nga Huamarrësi në lidhje me huan apo ndonjë detyrim që rrjedh nga një transaksion financiar i ndryshëm nga huaja:

ii) Huamarrësi kërkohet apo mund t'i kërkohet, pas mbarimit të një periudhe kontraktuale të zbatueshme pa pagim interesi, të parapaguajë, shlyejë, mbyllë apo mbarojë përpara maturimit huan apo detyrimin; ose

iii) çdo angazhim financiar për ndonjë hua apo detyrim tjetër, anulohet apo pezullohet.

d) Huamarrësi është i paaftë të paguajë borxhin në kohën e duhur apo të pezullojë borxhet e tij, apo pa njoftim paraprak me shkrim për Bankën, kërkon të bëjë marrëveshje me kreditorët e saj;

e) Huamarrësi nuk përmbush në kohë detyrimet në lidhje me ndonjë hua tjetër të dhënë nga Banka ose nga burimet e Bankës apo të ndonjë instrumenti financiar të kontraktuar me Bankën;

f) Huamarrësi nuk përmbush në kohë detyrimet në lidhje me ndonjë hua tjetër të bërë nga burimet e BE-së;

g) Pas një vonese të Huamarrësit në përmbushjen e detyrimit për huan ose grantin e përmendur në paragrafin hyrës 2 apo çdo granti të dhënë atij nga Bashkimi Europian, e drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e asaj huaje apo granti, tërësisht apo pjesërisht, do të kishte qenë e anuluar apo përfunduar, apo nëse ajo hua apo grant do të ishte bërë e shlyeshme sipas kushteve të saj;

h) Nëse ndodh një ndryshim material i pafavorshëm; ose

i) Nëse bëhet e paligjshme për Huamarrësin të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, ose nëse kjo kontratë nuk është efektive në përputhje me kushtet e saj ose pretendohet nga Huamarrësi që të jetë joefektive në përputhje me kushtet e saj.

10.01B Kërkesa pas njoftimit për kompensim

Gjithashtu, Banka mund të bëjë një kërkesë të tillë nëse:

a) Huamarrësi nuk plotëson detyrimet e tij sipas kësaj kontrate që nuk është detyrim i përmendur në nenin 10.01A; ose

b) çdo fakt në lidhje me Huamarrësin apo projektin e deklaruar në paragrafët hyrës ndryshon materialisht dhe nuk ruhet materialisht, dhe nëse ndonjë ndryshim ose cenon interesin e Bankës si Huadhënës për Huamarrësin, ose ndikon në mënyrë të pafavorshme në zbatimin apo veprimtarinë e projektit,

nëse mosplotësimi apo rrethanat e lindura për mosplotësimin mund të ndreqen dhe ndreqen brenda një afati kohor të pranueshëm, të specifikuar në një njoftim të Bankës për Huamarrësin.

10.02 Të drejta të tjera me ligj

Neni 10.01 nuk kufizon ndonjë të drejtë tjetër të Bankës me ligj për të kërkuar shlyerjen e huas.

10.03 Kompensimi

10.03A Transhet me normë fikse

Në rastin e kërkesës sipas nenit 10.01 në lidhje me ndonjë transh me normë fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me kompensimin e parapagimit në çdo shumë të



principalit që duhet paguar. Ky kompensim parapagimi do të akumulohet nga data e pagesës, së specifikuar në njoftimin e kërkesës së Bankës dhe të llogaritur mbi bazën që ai parapagim të kryhet në datën e caktuar.

10.03B Transhet me normë të ndryshueshme

Në rastin e kërkesës sipas nenit 10.01 në lidhje me një transh me normë të ndryshueshme, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me një shumë të barabartë me vlerën aktuale prej 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë) në vit llogaritur dhe akumuluar mbi vlerën e principalit për t'u parapaguar në të njëjtën mënyrë, pasi interesi do të ishte llogaritur dhe akumuluar, nëse ajo shumë ka mbetur e papaguar sipas planit të amortizimit të transhit deri në datën e maturimit.

Vlera do të llogaritet me një normë zbritjeje të barabartë me normën e rivendosjes së zbatuar në çdo datë pagese përkatëse.

10.03C Të përgjithshme

Vlerat për t'u paguar nga Huamarrësi, sipas këtij neni 10.03, do të jenë të pagueshme në datën e parapagimit të specifikuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Dokumenti mbi mosmbajtjen e përgjegjësisë për humbjet

Asnjë dështim, vonesë apo ushtrim i vetëm apo i pjesshëm nga Banka në ushtrimin e të drejtave apo mjeteve të saj ligjore sipas kësaj kontrate, nuk interpretohet si dokument mbi mosmbajtjen e përgjegjësisë për humbjet, të këtyre të drejtave apo mjeteve ligjore që sipas kësaj kontrate janë kumulative dhe jo përjashtuese nga të drejtat apo mjetet ligjore të parashikuara me ligj.

Neni 11

Ligji dhe juridiksioni

11.01 Ligji rregullues

Kjo kontratë dhe çdo detyrim tjetër jokontraktual, që lind prej saj apo në lidhje me të, do të rregullohet nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.02 Juridiksioni

Palët i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Drejtësisë të Komunitetit Europian.

Palët e kësaj kontrate heqin dore nga çdo imunitet apo nga e drejta për të kundërshtuar juridiksionin e këtyre gjykatave. Një vendim i gjykatave, i dhënë sipas këtij neni, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët pa kufizime apo rezerva.

11.03 Dëshmia e shumave të kërkueshme

Në çdo veprim ligjor që lind jashtë kësaj kontrate, certifikata e Bankës për vlerat e një norme për t'u paguar ndaj Bankës, sipas kësaj kontrate, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jetë dëshmi *prima facie* për këtë shumë ose normë.

Neni 12

Klauzolat përfundimtare

12.01 Njoftimet për çdo palë

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna sipas kësaj kontrate drejtuar palës tjetër të kësaj kontrate, do të bëhen në adresën apo numrin e faksit si më poshtë, ose në një adresë apo numër faksi që njëra palë i njofton tjetrës më parë me shkrim:

Për Bankën

Në vëmendje të: Ops A
100 Boulevard Konrad Adenauer
L-2950 Luksemburg
Faks: +352 4379 67487

Për Huamarrësin

Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1
Tiranë, Shqipëri
Faks: +355 4 222 8494

Kopje për Zbatuesin

Në vëmendje të: Autoritetit Rrugor Shqiptar
Ekipi i zbatimit të projektit
Drejtori i EZP-së
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë
Rr. "Sami Frashëri" nr. 33
Tiranë, Shqipëri
Faks: +355 4 2259 898

12.02 Formulari i njoftimit

Çdo formë njoftimi apo komunikimi sipas kësaj kontrate duhet të jetë me shkrim.

Njoftimet apo format e tjera të komunikimit, për të cilat periudha fikse përcaktohen në këtë kontratë apo që caktojnë periudha detyruese për marrësin, duhet të bëhen me dërgim dorazi, me postë rekomande ose faks. Këto njoftime dhe komunikime do të çmohen të marra nga pala tjetër në datën e dorëzimit në lidhje me shkresën e dërguar dorazi ose me postë rekomande ose me konfirmimin e marrjes në lidhje me transmetimin me faks.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera mund të dërgohen dorazi, me postë rekomande apo faks ose në masën e rënë dakord nga palët, me marrëveshje me shkrim, *e-mail* apo komunikim elektronik.

Pa cenuar vlefshmërinë e ndonjë njoftimi të marrë me faks sipas paragrafëve të mësipërm, një kopje e çdo njoftimi të dërguar me faks do të dërgohet edhe me shkresë te pala tjetër jo më vonë se në ditën e nesërme të punës.

Njoftimet e lëshuara nga Huamarrësi sipas dispozitave të kësaj kontrate, do t'i dorëzohen Bankës të nënshkuara dhe të ekzekutuara nga nënshkruesi i autorizuar i kësaj kontrate. Nëse kjo nuk është më e vlefshme për ndonjë arsye, njoftimet do të dorëzohen te Banka së bashku me provat e pranueshme të autoritetit të personit apo personave të autorizuar për të nënshkruar këtë njoftim në emër të Huamarrësit dhe nënshkrimin model të vërtetuar të këtij personi apo personave.

12.03 Amendimi

Çdo amendim i kushteve të kësaj kontrate financiare do të bihet dakord me shkrim ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

12.04 Ndryshimet për palët

Huamarrësi nuk mund të caktojë apo transferojë ndonjë prej të drejtave apo detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

Banka nuk mund të caktojë apo transferojë (me anë të novacionit, grupeve bankare ose ndryshe), tërësisht apo pjesërisht, ndonjë nga të drejtat dhe përfitimet apo detyrimet sipas kësaj kontrate, përveç nëse (dhe në çdo rast me njoftim paraprak me shkrim te Huamarrësi):

a) Caktimi, novacioni apo transferimi është bërë në favor të:

i) Komisionit të Bashkimit Europian; ose

ii) Fondit Europian të Investimeve; ose

iii) një institucioni financiar, një agjencie eksport-kredie apo një institucioni shumëpalësh zhvillimi, ku Banka (ose shtetet anëtare) janë aksionere; ose

iv) Banka Qendrore Europiane ose çdo bankë qendrore kombëtare në një nga shtetet anëtare.

b) Caktimi apo transferimi bëhet pas ndodhjes së një rasti sipas nenit 10.01 ose në lidhje me transaksione të strukturuar financiare.

Huamarrësi jep miratimin e tij të parevokueshëm për transferimin e këtyre marrjeve të pritshme të parave, të drejtave dhe detyrimeve dhe ndërmerr të pranojë (nëse kërkohet) transferimin e marrjeve të pritshme të parave si më sipër.

12.05 Paragrafët hyrës, skedulet dhe aneksi



Paragrafët hyrës dhe skedulet e mëposhtme janë pjesë e kësaj kontrate:

Skeduli A	Përshkrimi teknik dhe raporti
Skeduli B	Përkufizimi i EURIBOR
Skeduli C	Formularët për Huamarrësin
Skeduli D	Kushtet pararendëse dhe certifikatat e Huamarrësit
Skeduli E	Formularët A/B

Bashkëlidhur aneksi i mëposhtëm:

Aneksi I Autorizim i nënshkrimit të Huamarrësit

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar kontratën në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe në emër të tyre kanë sigluar çdo faqe të kësaj kontrate përkatësisht z. Xhentil Demiraj dhe z. Lawrence Walsh

Në Tiranë, 11 qershor 2012 Nënshkruar për dhe në emër të REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Ministri i Financave Ridvan BODE	Nënshkruar për dhe në emër të BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE Zëvendëspresidenti Dario SCANNAPIECO
---	--

Skeduli A

SPECIFIKIMI I PROJEKTIT DHE RAPORTIMI

A.1 PËRSHKRIMI TEKNIK (NENI 6.02)

Qëllimi, vendi

Projekti ka lidhje me ndërtimin e rreth 22 km rrugë autostradë me dy kalime në një drejtim të ri rreth qytetit të Fierit, me vendndodhje pranë bregdetit në Shqipërinë Qendrore. Ky është segmenti i fundit i mbetur në aksin kryesor veri-jug ndërmjet Tiranë-Durrës dhe Greqisë, për t'u përmirësuar. Qëllimi është të përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe për të lehtësuar kongestionin dhe problemet mjedisore në Fier.

Përshkrimi

Projekti ka lidhje me ndërtimin e një seksioni të aksit veri-jug nga Durrësi/Tirana në Greqi dhe Porti Vlorë, të një rruge dykalimëshe standarde rreth qytetit Fier. Gjatësia totale do të jetë rreth 22 km në një drejtim të ri me asfalt prej 22 metra dhe shpejtësi 120 km/orë (me 90 km/orë në një segment të vogël pranë Mbrostar).

Rruga lidh rrugën e ndërtuar së fundmi (Lushnjë-Fier) në pjesën lindore të Fierit në Mbrostar dhe lidhet në jug në Levan me dy rrugë (në ndërtim). Njëra rrugë çon në portin e qytetit të Vlorës dhe tjetra në Tepelenë drejt kufirit grek (të dyja aktualisht të financuara nga Banka).

Projekti përfshin:

- Kryqëzime të ndara 4 gradë;
- 2 gjysmëshkëmbime të përmirësuara;
- 3 ura (afërsisht 80 m gjatësi secila);
- mbikalime të ndryshme hekurudhore dhe lokale;
- masa menaxhimi mjedisore;
- blerje e tokave dhe rivendosje, që do të financohet nga Huamarrësi në tërësi;
- shërbime konsulence për mbikëqyrjen e punimeve, monitorimin dhe auditivin, si dhe asistencën teknike për të mbështetur zbatimin.

Kalendari

Ndërtimi i projektit pritet të fillojë në tremujorin 1, 2012 dhe të përfundojë deri në tremujorin 4, 2015.

A.2 INFORMACION PËR PROJEKTIN QË DO T'I DËRGOHET BANKËS DHE MËNYRA E TRANSMETIMIT

Detyrimet informative sipas nenit 8.01(a)

1. Dërgimi i informacionit: caktimi i personave përgjegjës

Informacioni i mëposhtëm duhet t'i dërgohet Bankës me përgjegjësinë e:

Zbatuesi	Autoriteti Rrugor Shqiptar
Personi i kontaktit	Z. Ylli Gjoni
Titulli	Drejtuues i grupit të zbatimit të projektit
Funksioni/departamenti	Zëvendës drejtor i përgjithshëm
Adresa	Rr. "Sami Frashëri", nr. 33 Tiranë, Shqipëri
Telefon	+355 2 2259898
Faks	+355 2 2259898
E-mail	ylli.gjoni@gmail.com

Personi(at) i(e) kontaktit si më lart është (janë) kontaktet përgjegjëse gjatë kësaj kohe. Huamarrësi do të informojë BEI-n menjëherë në rast ndryshimi.

2. Informacion mbi tema specifike

Huamarrësi do të dorëzojë apo kërkojë që zbatuesi të dorëzojë te Banka informacionin si vijon deri në fund të afatit të mëposhtëm:

Dokumenti/informacioni	Afati
- Një audit të sigurisë rrugore të projektimit të detajuar, i përbushur në përputhje me parimet e udhëzimit të BE-së 2008/96/EC - Ekuivalentë të formularëve A/B nga autoritetet kompetente të ruajtjes së natyrës - Vendimin e autoritetit kompetent mjedisor dhe autoritetin për arkeologjinë dhe mendim kulturor - Prova që dëshmojnë se të gjitha blerjet e tokave dhe rivendosjes për projektin janë plotësuar në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën	Disbursimi i parë
Prova të pranueshme për Bankën - Funksionim i grupit të zbatimit të projektit - GZP - Inxhinier mbikëqyrës i mobilizuar	Çdo disbursim
Plan veprimtarie dhe mirëmbajtje për rrugën, i pranueshëm për Bankën	Gjashtë muaj para hapjes
Përditësim vjetor për: i) zbatimin e planit të veprimit të reformës sektoriale; ii) shpenzimet për mirëmbajtjen e rrugëve kombëtare për vitin e kaluar fiskal; iii) buxhetin e mirëmbajtjes së rrugëve kombëtare të vitit fiskal	30 prill çdo vit

3. Informacion mbi zbatimin e projektit

Huamarrësi do të dorëzojë apo kërkojë që zbatuesi t'i dorëzojë Bankës informacionin si vijon mbi progresin e projektit gjatë zbatimit deri në afatin e treguar më poshtë:

Dokument/informacion	Afati	Shpeshtësia e raportimit
Progresraportin për projektin: - Një përditësim i shkurtër për përshkrimin teknik, që shpjegon arsyet për ndryshime domethënëse kundrejt qëllimit fillestar; - Një përditësim për datat e plotësimit të çdo komponenti bazë të projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë vonesë të mundshme;	31 dhjetor dhe 30 qershor	Gjashtëmujore



- Një përditësim mbi kostot e projektit, që shpjegon arsyet për ndonjë rritje të mundshme të kostos kundrejt kostos në buxhetin fillestar; - Një përditësim i ndonjë çështjeje kryesore me ndikim në mjedis; - Nëse ka një përditësim mbi procedurat e prokurimit; - Çdo çështje domethënëse që ka ndodhur apo ka rrezik që mund të ndikojë në veprimtarinë e projektit; - Çdo veprim ligjor në lidhje me projektin dhe që mund të vazhdojë; - Një përditësim mbi progresin, duke vënë në veprim autoritetin rrugor shqiptar		
---	--	--

4. Informacion mbi përfundimin e punimeve dhe vitin e parë të veprimtarisë

Huamarrësi do të dorëzojë apo kërkojë që zbatuesi t'i dorëzojë Bankës informacionin si vijon mbi përfundimin e projektit dhe fillimin e veprimtarisë deri në afatin e treguar më poshtë:

Dokument/informacion	Data e dorëzimit në Bankë
Raporti përfundimtar i projektit që përfshin: - Një përshkrim i shkurtër të karakteristikave teknike të projektit pas përfundimit, që shpjegon arsyet për ndonjë ndryshim domethënës; - Data e përfundimit të çdo komponenti kryesor të projektit, që shpjegon arsyet për ndonjë vonesë të mundshme; - Kostoja përfundimtare e projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë rritje të kostos kundrejt kostos së buxhetit fillestar; - Numri i punëve të reja krijuar nga projekti; të dyja punët gjatë zbatimit dhe punë të përhershme të krijuara; - Një përshkrim të ndonjë çështjeje kryesore me ndikim në mjedis; - Përditësim mbi procedurat e prokurimit (jashtë BE-së); - Përditësim mbi kërkesën apo përdorimin e projektit dhe komente; - Çdo ndryshim domethënës që ka ndodhur dhe rrezik që mund të ndikojë në veprimtarinë e projektit. - Lista e akseseve rrugore në rrugën e projektit, e paparashikuar në dokumentet e planprojektit përfundimtar; - Faza 5 e auditit të sigurisë rrugore në përputhje me parimet e udhëzimit të BE-së 2008/96/EC; - Çdo veprim ligjor në lidhje me projektin që mund të jetë në proces	15 muaj pas hapjes ose prill 2016, cilado që bie më herët

Gjuha e raportit

Anglisht

SKEDULI B

PËRKUFIZIMI I EURIBOR

A. EURIBOR

EURIBOR është:

a) Në lidhje me një periudhë përkatëse prej jo më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në euro për një periudhë prej një muaj;

b) Në lidhje me një periudhë përkatëse të një apo më shumë muajsh të plotë, norma e interesit për depozitat në euro për një periudhë të numrit korrespondues të muajve të plotë; dhe

c) Në lidhje me një periudhë përkatëse prej më shumë se një muaj (por jo muaj të plotë), norma që rezulton nga një futje lineare me referencë në dy norma për depozitat në euro, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë muajsh të plotë më pas të shkurtër dhe për një periudhë muajsh të plotë më të gjatë sesa gjatësia e periudhës përkatëse,

(periudha për të cilën norma është marrë ose nga të cilat normat janë ndërfutur quhet “Periudha përfaqësuese”),

Nr	Qarku	Rrethi	Njesite e Qeverisjes Vendore	Bashki (B) Komune (K)	Transferta e Pakushtezuar	Subvencion për furnizimin me ujë të pijshëm	TOTAL
320	Shkodër	Shkodër	Vellipojë	K	12.758	3.190	15.948
321	Shkodër	Shkodër	Dajç (Bregbunë)	K	16.704	0	16.704
322	Shkodër	Shkodër	Ana e Malit	K	9.378	1.931	11.309
323	Shkodër	Shkodër	Rrethinat	K	36.123	6.694	42.817
324	Shkodër	Shkodër	Temal	K	10.792	0	10.792
325	Gjirokastrë	Tepelenë	Tepelenë	B	20.685	8.165	28.851
326	Gjirokastrë	Tepelenë	Memaliaj	B	15.124	6.482	21.606
327	Gjirokastrë	Tepelenë	Qendër	K	11.335	2.834	14.169
328	Gjirokastrë	Tepelenë	Fshat Memaliaj	K	7.939	1.985	9.923
329	Gjirokastrë	Tepelenë	Krahëz	K	10.534	2.633	13.167
330	Gjirokastrë	Tepelenë	Qesarat	K	5.457	1.364	6.822
331	Gjirokastrë	Tepelenë	Luftinjë	K	16.651	0	16.651
332	Gjirokastrë	Tepelenë	Buz	K	9.539	0	9.539
333	Gjirokastrë	Tepelenë	Kurvelesh	K	10.131	1.525	11.657
334	Gjirokastrë	Tepelenë	Lopez	K	6.663	0	6.663
335	Tiranë	Tiranë	Vorë	B	35.729	8.833	44.562
336	Tiranë	Tiranë	Kamëz	B	187.668	17.163	204.832
337	Tiranë	Tiranë	Petrelë	K	11.583	748	12.332
338	Tiranë	Tiranë	Bërzhitë	K	17.484	159	17.643
339	Tiranë	Tiranë	Baldushk	K	12.983	136	13.119
340	Tiranë	Tiranë	Zall Bastar	K	22.058	0	22.058
341	Tiranë	Tiranë	Shëngjergj	K	16.455	92	16.547
342	Tiranë	Tiranë	Dajt	K	22.434	5.609	28.043
343	Tiranë	Tiranë	Vaqarr	K	14.671	1.000	15.672
344	Tiranë	Tiranë	Pezë	K	16.601	484	17.085
345	Tiranë	Tiranë	Ndroq	K	13.806	3.452	17.258
346	Tiranë	Tiranë	Prezë	K	9.158	2.290	11.448
347	Tiranë	Tiranë	Zall Herr	K	18.318	1.055	19.373
348	Tiranë	Tiranë	Paskuqan	K	72.689	1.405	74.094
349	Tiranë	Tiranë	Bërxullë	K	16.912	533	17.445
350	Tiranë	Tiranë	Kashar	K	33.347	528	33.874
351	Tiranë	Tiranë	Farkë	K	18.178	1.051	19.229
352	Tiranë	Tiranë	Krrabë	K	10.701	91	10.791
353	Kukës	Tropojë	Bajram Curri	B	30.501	2.807	33.307
354	Kukës	Tropojë	Fshat Tropoje	K	22.952	1.874	24.826
355	Kukës	Tropojë	Bytyç	K	13.546	681	14.227
356	Kukës	Tropojë	Lekbibaj	K	15.783	0	15.783
357	Kukës	Tropojë	Fierzë	K	11.064	970	12.034
358	Kukës	Tropojë	Margegaj	K	17.667	1.016	18.684
359	Kukës	Tropojë	Bujan	K	11.866	1.536	13.402
360	Kukës	Tropojë	Llugaj	K	8.481	2.120	10.601
361	Vlorë	Vlorë	Vlorë	B	202.453	86.765	289.218
362	Vlorë	Vlorë	Orikum	B	22.523	9.653	32.175
363	Vlorë	Vlorë	Selenicë	B	14.803	6.344	21.146
364	Vlorë	Vlorë	Himarë	B	25.725	8.920	34.646
365	Vlorë	Vlorë	Qendër	K	28.787	7.197	35.984
366	Vlorë	Vlorë	Novoselë	K	25.517	6.379	31.897
367	Vlorë	Vlorë	Brataj	K	20.323	0	20.323
368	Vlorë	Vlorë	Horë Vranisht	K	20.043	44	20.087
369	Vlorë	Vlorë	Shushicë	K	14.528	3.632	18.160
370	Vlorë	Vlorë	Vilahinë	K	17.055	2.680	19.735
371	Vlorë	Vlorë	Kotë	K	11.864	2.966	14.830
372	Vlorë	Vlorë	Sevastar	K	15.434	0	15.434
373	Vlorë	Vlorë	Armen	K	16.383	4.096	20.479
Fondi për Zhvillimin e Rajoneve							2.300.000
TOTALI					11.390.199	1.252.059	12.775.860

Tab. 6

TREGUESIT FISKALE TE BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2012
(FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2012)

ne milion leke (in million of leks)

Nr.	EMERTIMI	Buxheti 2012	Ne % te PBB	Buxheti i Shtetit	Buxhetet e Fondeve Speciale	Buxheti Vendor	ITEMS
	TOTALI TE ARDHURAVE	355.759	25,6%	281.622	59.513	14.624	TOTAL REVENUE
I.	Te ardhura nga ndihmat	9.843	0,7%	9.843			Grants
	Nga kjo: Mbeshtetje buxhetore	0	0,0%	0			From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	325.306	23,4%	251.168			Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	251.168	18,1%	251.168			From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	127.299	9,2%	127.299			V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	21.980	1,6%	21.980			Profit Tax
3	Akcizat	42.759	3,1%	42.759			Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	29.754	2,1%	29.754			Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	22.598	1,6%	22.598			National Taxes and others
6	Taksa Doganore	6.778	0,5%	6.778			Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	14.624	1,1%			14.624	Local Taxes
1	Taksa Lokale	9.409	0,7%			9.409	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	2.132	0,2%			2.132	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	3.083	0,2%			3.083	Small Business Tax
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	59.513	4,3%		59.513		Revenues from Special Funds
1	Sigurimi Shoqeror	51.577	3,7%		51.577		Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	6.436	0,5%		6.436		Health insurance
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlerë te pronareve	1.500	0,1%		1.500		Revenues for owners' in value-compensation
III.	Te ardhura Jotimore	20.611	1,5%	20.611			Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shoqerise	4.500	0,3%	4.500			Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	12.411	0,9%	12.411			Income of budgetary institutions
3	Dividenti	700	0,1%	700			Divident
4	Tarifat e Sherbimeve	2.500	0,2%	2.500			Services Fees
5	Te tjera	500	0,0%	500			Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	396.922	28,6%	245.420	121.999	28.500	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	322.389	23,2%	170.887	121.999	28.500	Current Expenditures
1	Personeli	70.866	5,1%	70.866			Personnel expenditures
	Paga	58.535	4,2%	58.535			Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	9.400	0,7%	9.400			Social insurance contributions
	Fondi i vecante i pagave	1.931	0,1%	1.931			Bonus fund
	Politikat e reja pagash	1.000	0,1%	1.000			Contingency for new policies
2	Interesat	49.600	3,6%	49.600			Interest
	Te Brendshme	40.000	2,9%	40.000			Domestic
	Te Huaja	9.600	0,7%	9.600			Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	29.062	2,1%	29.062			Operational & Maintenance
4	Subvencionet	1.600	0,1%	1.600			Subsidies
5	Shpenzime per Fondet Speciale	121.999	8,8%		121.999		Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	89.765	6,5%		89.765		Social insurance
	Politika te reja pensionesh	1.500	0,1%		1.500		Contingency for new policies
	Sigurime Shendetesore	28.934	2,1%		28.934		Health insurance
	Shpenzime per Kompensimin ne Vlerë te Pronareve	1.800	0,1%		1.800		Expenditure for owners' in value-compensation
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	29.503	2,1%			28.500	Local Budget expenditure
	Granti nga buxheti i shtetit per pushtetin vendor	13.876	1,0%			13.876	Local Budget (Grant)
	Fondi i pakushtezuar	10.190	0,7%				Unconditional Fund
	Subvencion per furnizimin me uje te pijshem	1.252	0,1%				Subsidy for the supply of drinking water
	Fondi i Zhvillimit te Infrastruktures Rurale	2.300	0,2%				Rural Infrastructure Development Fund
	Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	14.624	1,1%			14.624	Local Budget (Own revenues)
	Buxheti Lokal (Te ardhurat nga taksat e ndara)	1.003	0,1%			1.003	Local Budget (Revenues from the shared taxes)
7	Shpenzime te tjera	19.759	1,4%	19.759			Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	1.000	0,1%	1.000			Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	17.059	1,2%	17.059			Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	1.700	0,1%	1.700			Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energjine elektrike	0	0,0%	0			Compensation for electricity
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	4.661	0,3%	4.661			Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	2.000	0,1%	2.000			CoM Reserve Fund
	Fond Kontigjenca per ruajtjen e deficitit	2.661	0,2%	2.661			Contingency for deficit financing
III.	Shpenzime Kapitale	69.872	5,0%	69.872			Capital expenditures
	Financimi Brendshem	27.501	2,0%	27.501			Domestic financing
	Financimi Huaj	42.371	3,0%	42.371			Foreign financing
	DEFICITI	-41.163	-3,0%	36.202	-62.486	-13.876	Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	41.163	3,0%	-36.202	62.486	13.876	Financing (Cash)
	Brendshem	18.815	1,4%				Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	300	0,0%				Privatization receipts
	Hua-marrije e brendshme	18.515	1,3%				Domestic borrowing
	Huaj	22.348	1,6%				Foreign
	Hua afatgjate (e marre) per projekte	32.528	2,3%				Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-10.180	-0,7%				Repayments
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB)	1.389.791					



VENDIM
Nr. 589, datë 5.9.2012

PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas datës 7 shtator 2012, botimi i çdo lloj njoftimi për prokurim të fondeve buxhetore për shpenzime operative të njërive të qeverisjes qendrore, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të bëhet me miratimin paraprak të Ministrit të Financave, pas vlerësimit të burimit të financimit.

Nuk kërkohet miratimi paraprak i Ministrit të Financave për botimin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara.

Përfshihen nga rregulli i parashikuar në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij vendimi, fondet buxhetore, që shkojnë për shërbimin e ushqimit apo medikamenteve në ato njësi të qeverisjes qendrore, në të cilat kryhet ky shërbim dhe prokurimet me vlerë të vogël.

2. Masa e mbulimit të shërbimit të telefonisë celulare të reduktohet 20%, për çdo përfitues sipas përcaktimeve të vendimit nr. 864, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë”.

3. Çdo funksion në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i miratuar në organikë dhe i paplotësuar ende, të ngrihet deri në fund të vitit. Përfshihen nga ky kufizim vendet e paplotësuara, për të cilat është realizuar konkursi, si dhe raste tepër specifike, për të cilat merret miratimi i Ministrit të Financave.

4. Kërkesat për iniciimin e akteve të Këshillit të Ministrave për miratimin e punonjësve me kontratë të përkohshme në njësitë e qeverisjes qendrore pezullohen.

5. Fondi i veçantë, i planifikuar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblime deri në datën 5 dhjetor 2012.

6. Shpenzimet për udhëtim e dieta jashtë vendit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të reduktohen, nëpërmjet minimizimit të udhëtimeve, përjashtuar ato të një rëndësie të veçantë dhe vetëm për një numër të kufizuar punonjësish. Në çdo rast, për kryerjen e këtyre udhëtimeve të merret miratimi i ministrit/titullarit të institucionit qendror. Në rastin e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete, për të cilat paguhet tarifë pjesëmarrjeje, merret paraprakisht miratimi i Ministrit të Financave.

7. Trajnimet/seminaret/kurset jashtë vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t’u mbuluar plotësisht apo pjesërisht me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2012, bllokohen.

8. Fondet buxhetore të papërdorura deri në miratimin e këtij vendimi për trajnimet/seminaret/kurset, përfshirë këtu edhe trajnimet e ITAP-it brenda vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t’u mbuluar plotësisht apo pjesërisht me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2012, të reduktohen në masën mbi 50%.

9. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësive të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 14, datë 20.7.2012

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË
TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK
2012-2013**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës pika 5 të nenit 33 dhe 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar të vendimit nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2012-2013”; të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar; të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2012-2013, të bëhet sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).

2. Kandidatët fitues të përcaktohen nga AKP-ja në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore) dhe për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr. 12, datë 11.7.2012 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për zhvillimin e konkurseve të pranimi, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2012- 2013”.

b) Parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese, ndër jo më shumë se 10 preferenca të përzgjedhura nga ata vetë në formularin A2.

3. Pas përfundimit të konkurseve në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, rezultatet e tyre në formë shkresore dhe elektronike të dorëzohen nga këto të fundit në AKP brenda orës 14:00 të datës 6 shtator 2012. AKP-ja brenda datës 13 shtator 2012 të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës listat paraprake të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë fituese të kërkuar prej tyre në formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2012-2012”.

4. Listat paraprake të kandidatëve fitues shpallen në faqen zyrtare elektronike të MASH-it dhe u dërgohen, në formë të shkruar dhe elektronike, institucioneve publike të arsimit të lartë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Provimeve në datën 13 shtator 2012. Këto institucione, duke filluar nga kjo datë, t’i afishojnë listat në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse.



5. Për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë të ngarkohen dekanatet e fakulteteve të institucioneve publike të arsimit të lartë. Ky proces do të jetë nën monitorimin e rektorateve dhe të Ministrisë së Arsimit e të Shkencës.

6. Regjistrimi i kandidatëve për të fituar statusin e studentit të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë të zhvillohet në dy faza:

6.1 Regjistrimi paraprak.

6.2 Regjistrimi përfundimtar.

7. Regjistrimi paraprak

7.1 Kandidatët fitues bëjnë regjistrimin paraprak të tyre në programin e studimit ku janë shpallur paraprakisht fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve nga data 14 shtator 2012 deri në datën 20 shtator 2012, nga ora 08:00 deri në orën 18:00.

7.2 Për regjistrimin paraprak, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Diplomë e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011, të dorëzojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (në qoftë se kandidati nuk ka dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme, ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme i lëshuar nga Arkivi Qendror i Shtetit);

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë paguar nëpërmjet zyrave të Postës Shqiptare për llogari të IAL-së publike përkatëse.

7.3 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit paraprak, sekretaritë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë, në të cilin kandidatët fitues nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.

7.4 Sekretaria mësimore pajis kandidatin që bën regjistrimin paraprak me një fletëregjistrimi paraprak, ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data dhe ora e regjistrimit.

Fletëregjistrimi paraprak duhet të jetë i nënshkruar nga dekani dhe kryesekretaria mësimore e fakultetit dhe i vulosur.

7.5 Kandidatët kanë të drejtë, nëse dëshirojnë të mos vazhdojnë garën të qëndrojnë të regjistruar në programin filluar në fazën e parë, duke nënshkruar një deklaratë sipas modelit në shtojcën 1 të këtij udhëzimi. Pas nënshkrimit të deklaratës, sekretaria mësimore pajis menjëherë kandidatët me vërtetim të regjistrimit përfundimtar. Kopje e deklaratave dërgohet nga sekretaria mësimore Në AKP së bashku me listën e regjistrimeve paraprake.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në orën 14:00 të datës 22 shtator 2012, të dorëzojnë në MASH dhe në AKP listën origjinale të përgatitur nga AKP-ja, me regjistrimet paraprake të kryera në formë të shkruar dhe elektronike, në dy kopje, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar.

9. Kandidatët, të cilët nuk kryejnë regjistrimin paraprak brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdolloj arsye, humbasin të drejtën e regjistrimit dhe të vazhdimit procesit. Këta kandidatë nuk do të përfshihen në listën përfundimtare të fituesve.

10. Në bazë të regjistrimeve paraprake të kryera dhe të vendeve të paplotësuara, AKP-ja, në datën 26 shtator 2012, të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues, duke ruajtur parimet e shprehura në pikën 2 të këtij udhëzimi. Lista shpallet edhe në faqen zyrtare elektronike të MASH-it.

11. Listat përfundimtare Të kandidatëve fitues në formë të shkruar dhe elektronike, t'u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve përkatëse të studimit në datën 26 shtator 2012 nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Institucionet publike të arsimit të lartë t'i afishojnë listat brenda datës 27 shtator 2012.

12. Regjistrimi përfundimtar

12.1 Kandidatët, të cilët në listat përfundimtare janë shpallur fitues në një program studimi të një preference të tyre më të lartë se ai i regjistrimit paraprak, do të çregjistrohen nga vetë sekretaritet mësimore nga programi i studimit ku ishin regjistruar më parë. Këta kandidatë tërheqin dosjen individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 7.2 të këtij udhëzimi, nga sekretaritet mësimore, ku janë çregjistruar dhe regjistrohen në programin e studimit në të cilin janë shpallur fitues me listat përfundimtare.

12.2 Sekretaritet mësimore të fakulteteve nga datat 28-30 shtator 2012, prej orës 8:⁰⁰ deri në orën 18:⁰⁰, të kryejnë çregjistrimet e kandidatëve, të përcaktuar në pikën 7.1 dhe të regjistrojnë kandidatët e rinj fitues, sipas listave përfundimtare të fituesve të shpallura nga AKP-ja dhe të dërguara nëpërmjet MASH-it.

12.3 Veprimet e çregjistrimit paraprak dhe ato të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj të dokumentohen në regjistër të veçantë.

12.4 Për kryerjen e procedurës së regjistrimit përfundimtar në sekretaritet mësimore të fakulteteve, kandidatët fitues që janë ngjitur në preferencë më të lartë kundrejt regjistrimit paraprak duhet të tërheqin dokumentacionin e dorëzuar te fakulteti ku u shpallën fitues në listën paraprake, si dhe të paraqiten në fakultetin e ri, ku janë shpallur fitues për t'u regjistruar. Ata bëjnë regjistrimin në fakultetin e ri duke dorëzuar dokumentacionin, si dhe duke nënshkruar në regjistrin e veçantë të sekretarisë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 7.3 të këtij udhëzimi.

12.5 Sekretaria mësimore duhet ta pajisë kandidatin që bën regjistrimin sipas pikës 7.4, me fletëregjistrimi ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data e ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë e nënshkruar nga dekani dhe nga kryesekretarja mësimore e fakultetit, si dhe të jetë i vulosur.

12.6 Kandidatët, të cilët edhe në listat përfundimtare rezultojnë fitues në të njëjtin program studimi nuk është e nevojshme të regjistrohen.

12.7 Tarifa e regjistrimit prej 1.600 lekësh, e arkëtuar për regjistrimin fillestar në universitetin X, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit ku universiteti X ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të universitetit Y, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i studentit dhe i shoqëruar me listën e studentëve.

13. Në përfundim të procesit të regjistrimit, studentët e regjistruar në regjistrin e veçantë të regjistrohen në regjistrin bazë të studentëve sipas udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 45, datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar.

14. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, aplikojnë direkt pranë IAL-ve publike, nga data 1-15 shtator 2012 sipas kuotave të përcaktuara në pikën 4 të vendimit nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit, për vitin akademik 2012-2013.

14.1 Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, bëhet nga IAL-të publike pritëse mbështetur në notën mesatare të shkollës së mesme edhe notat e lëndëve për të cilat IAL-të publike kanë vendosur koeficientët më të lartë për pranimet në këtë vit akademik. Në rast se numri i kandidatëve, që aplikojnë për t'u pranuar në një program të caktuar studimi, të cilët përmbushin kriteret E pranimit, është më i lartë se numri i kuotave të miratuara në vendimin nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, IAL-ja përcakton kriteret të veçanta pranimi për të përzgjedhur më të mirët.



14.2 Listat e kandidatëve fitues nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatëve shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, sipas programeve të ndryshme të studimit, dërgohen nga institucionet publike të arsimit të lartë në MASH dhe AKP, deri në datën 25 shtator 2012 dhe publikohen në vende të dukshme pranë fakulteteve përkatëse të IAL-ve, duke filluar nga data 26 shtator 2012.

15. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të cilët rezultojnë fitues sipas pikës 14.2 të këtij udhëzimi, të regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve nga data 27-30 shtator 2012, duke paraqitur dokumentet përkatëse, sipas pikës 7.2. Dokumentet e parashtruara në pikat 7.2.a dhe 7.2.b të këtij udhëzimi, të jenë në gjuhën shqipe e të noterizuara në Republikën e Shqipërisë. Në përfundim të regjistrimeve të këtyre kandidatëve, IAL-Të të dërgojnë listat e tyre në AKKP.

16. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga AKP-ja, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar për regjistrimin përfundimtar në formë të shkruar dhe elektronike në dy kopje, deri në datën 5 tetor 2012.

17. Pas procesit të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë, IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në aleatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore”.

18. Transferimi i studimeve nga institucionet private të arsimit të lartë në institucionet publike të arsimit të lartë dhe anasjellas, të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në statutet e institucioneve dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet transferimi i studimeve.

19. IAL-të i dërgojnë një listë të studentëve të transferuar, në formë shkresore dhe elektronike, AKP-së. AKP-ja bën përditësimin e të dhënave dhe transferimin e numrit individual të matrikullimit.

20. Rektoratet dhe dekanatet, në datën 10 shtator 2012 i shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit dhe të çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe njoftime që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e një ecurie normale të procesit të pranimeve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

21. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

22. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 17, datë 31.7.2012

**PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË ME KOHË TË PLOTË TË OFRUAR NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E
STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 33, 34 dhe 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Institucionet private të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimiit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë. Procesi monitorohet nga rektori i institucionit privat të arsimit të lartë (IAL private).

2. Institucionet private të arsimit të lartë, shpallin hapjen e procedurës së pranimiit të kërkesave të kandidatëve që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë dhe kriteret e pranimiit të tyre.

3. Aplikimi për regjistrim dhe regjistrimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet private të arsimit të lartë privat të kryhet deri në datën 15 nëntor 2012. Për aplikim, kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën e Maturës Shtetërore, së bashku me certifikatën e notave ose diplomën; dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri; dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011); si dhe certifikatën përkatëse, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve, që vërteton se ka fituar provimet me zgjedhje.

b) dokument identifikimi (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe:

i) lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noteruar);

ii) dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe);

iii) dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (njohur ndërkombëtarisht) në të cilën zhvillohet programi i studimit ku regjistrohet kandidati (me përjashtim të rastit kur gjuha e huaj është gjuha zyrtare e shtetit nga vjen kandidati).

4. Në qoftë se kandidati nuk ka dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga drejtorja arsimore rajonale/zyra arsimore ose listën e notave të shkollës së mesme lëshuar nga Arkivi Qendror i Shtetit.

5. IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) brenda datës 30 nëntor 2012, një listë të studentëve të regjistruar në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD). AKP-ja brenda datës 30 dhjetor 2013, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.

6. Aplikimi për regjistrin në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master profesional”, në institucionet private të arsimit të lartë të



kryhen deri në datën 15 nëntor 2012 nga IAL-të private. Për aplikim, kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopje të noteruar të diplomës së lëshuar në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) dokument identifikimi (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noteruar). Studentët, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në të njëjtën IAL private ku aplikojnë për t'u regjistruar në programet e studimit "Master i shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master profesional" nuk janë të detyruar të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm.

7. IAL-të private i dërgojnë AKP-së, brenda datës 30 nëntor 2012, një listë të studentëve të regjistruar në programet e studimit të ciklit të dytë, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD). AKP-ja brenda datës 30.12.2012, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.

8. Pas procesit të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë, IAL-të private përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore".

9. IAL-të private të regjistrojnë studentët në regjistrin bazë në përputhje me përcaktimet e urdhrit nr. 45, datë 19.12.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të ndryshuar.

10. Transferimi i studimeve nga institucionet publike të arsimit të lartë në institucionet private të arsimit të lartë dhe anasjelltas të bëhet, sipas kriterëve të përcaktuara në statutet e institucioneve dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet transferimi i studimeve.

11. IAL-të dërgojnë një listë të studentëve të transferuar në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), AKP-së. AKP-ja bën përditësimin e të dhënave dhe transferimin e numrit individual të matrikullimit.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM

Nr. 19, datë 6.9.2012

PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2012-2013 NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2012-2013 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë me kohë plotë, të fillojë në datën 8 tetor 2012 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2013.

2. Viti akademik 2012-2013 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, të fillojë në datën 22 tetor 2012 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2013.

3. Viti akademik 2012-2013 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, të fillojë në datën 8 tetor 2012 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2012.

4. Periudha 24 dhjetor 2012 deri më 4 janar 2013 të jetë në periudhë pushimesh për studentët.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtorinë e konvikteve listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

6. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e këtij udhëzimi për vitin akademik 2012-2013.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 326, datë 7.8.2012

**PËR AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË
“FIZIOTERAPI”, TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “ALDENT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Fizioterapi” të shkollës së lartë universitare jopublike “Aldent” në përputhje me vendimin nr. 353, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit.

2. Shkolla e lartë universitare jopublike “Aldent”, bazuar në vendimin nr. 353, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, të plotësojë rekomandimet e paraqitura në të përpara fillimit të vitit të ri akademik 2012-2013.

3. Shkolla e lartë universitare jopublike “Aldent” do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4 neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Aldent”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



URDHËR
Nr. 327, datë 7.8.2012

**PËR AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE” NË
“MENAXHIM BANKAR”, “ADMINISTRIM BIZNESI”, “PSIKOLOGJI KLINIKE” DHE
PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL”, NË “PSIKOLOGJI KLINIKE” TË
UNIVERSITETIT “ALBANIAN UNIVERSITY”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 355, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, e programeve të studimit “Master i shkencave” në:

- a) Menaxhim bankar;
- b) Administrim biznesi;
- c) Psikologji klinike.

2. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 355, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, e programit të studimit “Master profesional” në “Psikologji klinike”.

3. Universiteti “Albanian University” të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin nr. 355, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të vitit të ri akademik 2012-2013.

4. Universiteti “Albanian University” do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4 neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe universiteti “Albanian University”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 328, datë 7.8.2012

**PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT “BACHELOR”
TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI
PLANETAR I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin institucional, në përputhje me vendimin nr. 356, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, të shkollës së lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.

2. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 356, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” e programit të studimit “Bachelor” në:

- a) Teknologji informacioni;
- b) Informatikë ekonomike;
- c) Sociologji;
- d) Mësues i arsimit fillor;
- e) Mësues i arsimit parashkollor;
- f) Psikologji;
- g) Infermieri e përgjithshme.

3. Shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin e Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të vitit të ri akademik 2012-2013.

4. Shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës” do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4 neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private “Universiteti Planetar i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 329, datë 7.8.2012

PËR AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË SHKENCA POLITIKE ME PROFIL “ADMINISTRIM PUBLIK”, NË SHKENCA JURIDIKE, ME PROFILE: “E DREJTË BIZNESI”, “E DREJTË PUBLIKE” DHE NË ADMINISTRIM BIZNESI, ME PROFILE: “SHËRBIME BANKARE DHE FINANCIARE”, “MARKETING DHE MENAXHIM OPERACIONESH”, “FINANCË KONTABILITET”, “LIDERSHIP DHE MENAXHIM BURIMESH NJERËZORE” TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “UNIVERSITETI MARIN BARLETI”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 357, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti”, e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Shkenca politike”, me profil “Administrim publik”.

2. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 357, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti” e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Shkenca juridike”, me profile:

- a) E drejta publike;
- b) E drejtë biznesi.



3. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 357, datë 13.7.2012 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti”, e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Administrim biznesi”, me profile:

- a) Shërbime bankare dhe financiare;
- b) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
- c) Lidership dhe menaxhim burimesh njerëzore;
- d) Financë kontabiliteti.

4. Shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti” të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin e Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, përpara fillimit të vitit të ri akademik 2012-2013.

5. Shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti” do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4 neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare jopublike “Universiteti Marin Barleti”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.10.2012
Doli nga shtypi më 2.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 68 lekë